



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË**  
**TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË SHOQËRINË UJËSJELLËS**  
**KANALIZIME TIRANË SH.A.**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË**  
**INFORMACIONIT NË SHOQËRINË UJËSJELLËS KANALIZIME**  
**TIRANË SH.A**

**Tiranë, Mars 2023**

## PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>4</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	6
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	<b>7</b>
1.	Objekti i auditimit	7
2.	Qëllimi i auditimit	7
3.	Identifikimi i çështjes	7
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	7
5.	Përgjegjësitë e audituesve	8
6.	Kriteret e vlerësimit	8
7.	Standardet e auditimit	8
8.	Metodat e auditimit	8
9.	Dokumentimi i auditimit	9
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>9</b>
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	9
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	9
2.1	Struktura, standarde, aktet rregulluese për teknologjinë e informacionit dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit	<b>9-13</b>
2.2	Auditimi i zhvillimit dhe blerjes për teknologjinë e informacionit	<b>14-43</b>
a.	Procedurat e investimeve në fushën e TIK	
b.	Marrëveshjet e nivelit të shërbimit (Service Level Agreement-SLA)	
2.3	Auditimi i sistemeve	<b>43-50</b>
a.	Verifikim i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output	
b.	Përdoruesit e sistemeve, të drejtat dhe gjurmët e veprimeve në sistem	
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	
A.	<b>Masa Organizative</b>	<b>50</b>

✂ **LISTA E SHKURTIMEVE**

<b>KLSH</b>	- Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>ZKA</b>	- Zyra Kombëtare e Auditimit
<b>INTOSAI</b>	- Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>VKM</b>	- Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>ERU</b>	- Enti Rregullator i Ujit
<b>UKT</b>	- Ujësjetës Kanalizime Tiranë
<b>KRU</b>	- Kompania Rajonale e Ujësjetës
<b>Sh.A</b>	- Shoqëri Aksionere
<b>Mobiread</b>	- Sistemi i menaxhimit të leximeve të matëseve në UKT
<b>TIK</b>	- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
<b>MNSH</b>	- Marrëveshje Nivel Shërbimi
<b>TI (IT)</b>	- Teknologji Informacioni
<b>BCP</b>	- Business Continuity Plan
<b>BCC</b>	- Business Continuity Center
<b>DRC</b>	- Disaster Recovery Center
<b>OE</b>	- Operator Ekonomik
<b>AK</b>	- Autoriteti Kontraktor
<b>IP</b>	- Internet Protocol
<b>VPN</b>	- Virtual Private Network
<b>LAN</b>	- Local Area Network
<b>VLAN</b>	- Virtual Local area network
<b>MFK</b>	- Menaxhimi Financiar dhe Kontrollit

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi një Auditim mbi Teknologjinë e Informacionit në Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, nga data 03.11.2022 deri më datë 20.01.2023.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi drejtimet e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

### I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A., u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit me temë “*Auditimet Paralele të TI-së KLSH-ZKA*”, për zhvillimin e auditimeve paralel në institucione me aktivitet të ngjashëm. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, audituesit e Teknologjisë së Informacionit të dy institucioneve, kanë zhvilluar takime dhe diskutime të eksperiencave në drejtim të teknologjisë dhe vendit që ajo ka zënë në institucionet KRU Prishtina Sh.A dhe UKT Sh.A.

Grupi i auditimit të KLSH-s në çdo fazë të projektit të auditimit ka marrë pjesë në takime diskutimi me grupin e auditimit të ZKA-s, duke diskutuar dhe trajtuar çështjet e veçanta dhe të ngjashme që janë evidentuar përgjatë gjithë fazave respektive të auditimit.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit me nr. 968/1, u miratua nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me datë 3.11.2022.

### I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetjet kryesore, të paraqitura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi në mënyrë të përmbledhur sipas drejtimeve të auditimit, rezultuan si më poshtë:

Nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A nuk disponon një strategji institucionale si dhe një strategji mbi teknologjinë e informacionit, mungesa e të cilave sjell mangësi në vendosjen e prioriteteve të institucionit, politikave të sigurisë si dhe përmirësimin e infrastrukturës të TI të cilat do duhet të jenë në mbështetje të objektivave institucionale.	faqe 9-13	e lartë	<b>Rekomandimi:</b> Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimeve që ofron, duhet të marrë masa për identifikimin, hartimin dhe zhvillimin e elementëve strategjikë në Teknologjinë e Informacionit që mbështesin strategjinë institucionale, ku nevojiten të merren në konsideratë të gjitha proceset për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë.
2	Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit zhvilluar në drejtim të teknologjisë së informacionit për pajisje	faqe 13-43	e lartë	<b>Rekomandimi:</b> Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për:

	<p>kompjuterike, licenca dhe mirëmbajtje, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Specifikimet teknike që janë bërë pjesë e dokumenteve të tenderit, nuk janë hartuar nga grupet e ngritura për këtë qëllim dhe në përputhje me dispozitat ligjore si dhe urdhrat e brendshëm.</li> <li>- Metoda e përdorur për përlllogaritjen e fondit limit, bazuar në çmimet e tregut nuk është dokumentuar dhe argumentuar plotësisht në përputhje në përcaktimet e dispozitave ligjore.</li> <li>- Kërkesat e vendosura mbi kapacitetin teknik nuk janë argumentuar nga ana teknike, por vetëm nga ana ligjore, çfarë është në kundërshtim me nenin 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikuar në nenin 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.</li> <li>- Raportet periodike të mirëmbajtjes nuk janë dokumentuar në përputhje me specifikimet teknike që janë pjesë integrale e tyre.</li> </ul>			<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimin e specifikimeve teknike në prokurime të teknologjisë së informacionit, të cilat duhet të dokumentohen dhe argumentohen për çdo procedurë, përpara përlllogaritjes së fondit limit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ky dokument të nevojitet të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.</li> <li>- Njësia përgjegjëse për prokurimet në teknologjinë e informacionit, në përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, të marrë në konsideratë specifikime teknike të hartuara nga strukturat e ngritura për këtë qëllim. Në rastet e mungesës së kësaj strukture, specifikimet teknike përlllogaritja e fondit limit, kapaciteti teknik, grafiku i lëvrimit apo hartimi i kritereve, nevojiten të hartohen nga vetë njësia.</li> <li>- Dokumentimin dhe argumentimin e mënyrës së zgjedhur në llogaritjen e fondit limit, për procedura të zhvilluara për teknologjinë e informacionit. Ky dokument të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.</li> <li>- Argumentimin teknik dhe ligjor të çdo kërkesë të vendosur në kapacitetin teknik, për procedurat e prokurimit që lidhen me teknologjinë e informacionit. Ky dokument të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.</li> <li>- Ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të shërbimeve të mirëmbajtjes në teknologjinë e informacionit, në përputhje me kërkesat e parashikuara në specifikimet teknike, duke dokumentuar në këtë mënyrë të plotë gjurmën e shërbimit të realizuar nga ofruesi.</li> </ul> <p><b>Rekomandimi:</b> Autoriteti Kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për përzgjedhjen dhe zhvillimin e trajnimeve specifike të zyrtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit si dhe për raste të veçanta të kërkojë nga APP mendime paraprake për trajnimin e tyre me qëllim realizimin e procedurave në vijimësi në përputhje me dispozitat ligjore</p>
3	<p>Nga auditimi mbi sistemet informatike që disponon Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A, u konstatua se të dhënat e abonentëve, matësve si dhe faturim-</p>	faqe 44-51	e lartë	<p><b>Rekomandimi:</b> Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e rregullores dhe manualit të përdorimit për sistemin informatik të faturim-arkëtimit në të cilat të përcaktohen detyrimet dhe rëndësia e</p>

	<p>arkëtimin e administron me sistemin informatik “Billing”, por nuk disponon asnjë nga dokumentacionet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullore mbi përdorimin e sistemit;</li> <li>- Rregullore operacionale mbi veprimet sistemuese që kryhen në sistemin dhe bazën e të dhënave;</li> <li>- Manual përdorimi;</li> <li>- Diagramet e qarkullimit të informacionit;</li> <li>- Kodin në burim;</li> <li>- Dokumentacion udhëzues i ndërtimit.</li> </ul>			<p>veprimeve në këtë sistem, për çdo përdorues punonjës të institucionit që e akseson atë. Gjithashtu, të dokumentohen diagramet e qarkullimit të informacionit për secilin nga proceset që nis dhe përfundon nëpërmjet sistemit informatik të faturimit - arkëtimin, duke siguruar në këtë mënyrë gjurmën e proceseve që kryhen nëpërmjet sistemit.</p> <p><b>Rekomandimi:</b> Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e rregullores për veprimet operacionale, që nevojitet të kryhen në sistemin informatik për efekte sistemuese të shkaktuara nga gabimet njerëzore apo pamundësitë e njohura të sistemit nëpërmjet ndërfaqeve të sistemit. Për secilin prej ndryshimeve të parashikuara në rregullore të hartohen dhe miratohen formatet që sigurojnë gjurmën e veprimeve të kryera dhe të autorizuar sipas nevojës. Në këtë rregullore mund të përfshihen gjithashtu veprimet operacionale për pezullim të përkohshëm apo të përhershëm të aksesit të përdoruesve të jashtëm, dokumentimi i lidhjeve të reja, monitorimin periodik, që tregojnë për nivelin e aksesimit në sistemin informatik nga palët e treta që ofrojnë shërbime faturim – arkëtimin, për llogari të institucionit.</p>
4	<p>Nga auditimi mbi gjurmën elektronike të auditimit u konstatua se nuk gjenerohet gjurmë mbi veprimet që kryejnë përdoruesit e bazës së të dhënave.</p> <p>Për përdoruesit e sistemit nga ndërfaqja, ruhen të dhëna të pakta që janë: hyrja, dalja, IP e përdoruesit si dhe mënyra e daljes nga sistemi. Kjo gjurmë elektronike është e pamjaftueshme, për të siguruar të dhëna mbi aktivitetin e tyre. Në të dhënat e faturimit për periudhën objekt auditimi u konstatua vetëm në një rast për një kontratë të caktuar, mungojnë rekordet e faturimit, çfarë tregon mundësinë për ndërhyrje në bazën e të dhënave.</p>	faqe 44-51	e lartë	<p><b>Rekomandimi:</b> Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e politikave të sigurisë së të dhënave që aksesojnë përdoruesit e jashtëm dhe të brendshëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit.</p> <p><b>Rekomandimi:</b> Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa teknike për sistemimin e gjurmës elektronike të auditimit në sistemin informatik të faturimit-arkëtimin, si e vetmja mënyrë që siguron gjurmueshmërinë e të dhënave elektronike në rast të kundërve administrative dhe operacionale.</p>

### **I.3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit**

Mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, grupi i auditimit konstaton se në shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A mungojnë strategjia, politikat dhe aktet rregullativë që përcaktojnë drejtimin, përgjegjësitë dhe detyrimet mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit. Gjithashtu, ka munguar një planifikim dhe zhvillim në shërbime të reja informatike, që do të ndihmonin shoqërinë për arritjen e objektivave institucionale. Hapat e ndërmarrë në drejtim të rritjes së përdorimit, përmirësimit dhe sigurisë së shërbimeve që ofrohen nëpërmjet teknologjisë së informacionit janë të pamjaftueshëm, për të hyrë në procesin e sigurisë së të dhënave dhe vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje. Megjithëse nuk ka pasur problematika të mëdha në të dhënat elektronike, mundësia për humbjen e tyre, ndërprerjen apo tjetërsimin është e lartë.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 968/1, datë 03.11.2022 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 03.11.2022 deri në 20.01.2023, në UKT Sh.A, ku periodha e audituar është 01.01.2020 deri në 30.09.2022, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga audituesit:

1. E.C., përgjegjëse grupi;
2. R.A., anëtar;
3. M.P., anëtare.

### **II.1 Objekti i auditimit**

*Objekti i Auditimit TIK* është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatorë, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

### **II.2 Qëllimi i auditimit**

*Qëllimi i Auditimit TIK* është vlerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve TIK dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

Për të arritur në dhënien e një opinioni, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë eficiente.

### **II.3 Identifikimi i çështjeve**

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 968/1 Prot, datë 03.11.2022:

1. Struktura, standarde, aktet rregulluese për teknologjinë e informacionit dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit;
2. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes për teknologjinë e informacionit;
  - a. Procedurat e investimeve në fushën e TIK;
  - b. Marrëveshjet e nivelit të shërbimit (Service Level Agreement-SLA);
3. Auditimi i sistemeve;
  - a. Verifikim i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output;
  - b. Përdoruesit e sistemeve, të drejtat dhe gjurmët e veprimeve në sistem.

#### ***II.4 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar***

UKT Sh.A është institucioni përgjegjës për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Bashkinë e Tiranës, sipas ndarjes së re administrative - territoriale, në përputhje me ligjin nr.115/2014, “Për ndarjen administrative - territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë në zonën e shërbimit, për të cilin është licencuar nga ERU është:

- Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
- Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
- Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
- Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre;
- Kryerja e aktiviteteve laboratorike.

#### ***II.5 Përgjegjësitë e audituesve***

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi UKT Sh.A, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 30.09.2022, në drejtim të çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të Teknologjisë së Informacionit.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 968/1 Prot., datë 03.11.2022 miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon UKT Sh.A. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

#### ***II.6 Kriteret e vlerësimit***

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikën më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

*Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:*

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Kodi I Furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;
- Ligji nr.990, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët Dhe Shoqëritë Tregtare”;
- Statuti i Shoqërisë;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Rregulloret e UKT Sh.A;
- Rregulloret e miratuara nga CESK;
- Standardet TIK, etj.

#### ***II.7 Standardet e auditimit***

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të



cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

### ***II.8 Metodatat e auditimit***

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit;
- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi;
- Verifikime të sistemit si përdorues;
- Dokumentacioni i arkivuar i dosjeve të prokurimit, etj.

### ***II.9 Dokumentimi i auditimit***

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

## **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

### ***III.1 Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim***

UKT Sh.A është një Shoqëri Aksionere e organizuar në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, me aksionar Bashkinë Tiranë regjistruar.

Misioni i UKT është:

- Të ofroj furnizim me ujë të qëndrueshëm, të sigurt dhe të pandërprerë, për të gjithë klientët ekzistues dhe të rinj në zonën e re të shërbimit të Bashkisë Tiranë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Të sigurojë grumbullimin, trajtimin dhe largimin cilësor të ujërave të ndotura, për të mbrojtur shëndetin publik dhe në përputhje me rregulloret kombëtare për mjedisin;
- Të sigurojë një mjedis të sigurt, të përshtatshëm dhe të mirë ku nxitet komunikimi, bashkëpunimi, trajnimi dhe kompensimi për arritjet individuale të stafit;
- Të përmirësojë vazhdimisht performancën për të siguruar qëndrueshmëri financiare dhe për të qenë në gjendje të mbulojmë nevojat për investime të reja dhe rinovime të aseteve në kohën e duhur.

Teknologjia e informacionit është e rëndësishme në UKT Sh.A, pasi nëpërmjet saj institucioni kryen dhe administron kontratat dhe abonentët, leximet, të dhënat e matësve, faturimet dhe arkëtimet e shërbimit të ujësjellës kanalizimit si dhe taksat vendore.

### **III.2 PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT**

#### **III.2.1 Struktura, standarde, aktet rregulluese për teknologjinë e informacionit dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit.**

UKT Sh.A ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkisë aksionare të saj. Objekti i kësaj shoqërie brenda territorit të bashkisë së krijuar në bazë të ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në RSH"

dhe akteve të ndarjes, është shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij, mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm si dhe e impianteve të pastrimit të tyre, kryerja e aktiviteteve laboratorike etj.


Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 6,792,760,000 lekë për aksion.

Nga auditimi u konstatua se shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, nuk disponon një strategji institucionale si dhe një strategji mbi teknologjinë e informacionit mungesa e të cilave sjell mangësi në vendosjen e prioriteteve të institucionit. Gjithashtu, shoqëria nuk ka një plan strategjik mbi teknologjinë e informacionit e më tej planifikime strategjike mbi sigurinë e informacionit si dhe infrastrukturën TI në të cilën do duhej të ishin pasqyruar objektivat e lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre. Mungesa e një plani strategjik institucional të lidhur me teknologjinë e informacionit mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme të cilat mund të mbështesin mbarëvajtjen e punës dhe arrijten e objektiveve të institucionit nëpërmjet teknologjisë.

*Për sa më lart*, UKT duhet të kishte marrë masa për hartimin dhe zhvillimin e një strategjie mbi Teknologjinë e Informacionit, me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektiveve institucionale, ku duhet të përfshihet një plan mbi teknologjinë e informacionit dhe proceset për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë. Strategjia e TI përfaqëson lidhjen e përbashkët midis objektiveve të Strategjisë së TI dhe atyre të strategjisë së institucionit. Objektivat e strategjisë së TI duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të biznesit, kapacitetin aktual të TI për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve. Strategjia duhet të marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës dhe arkitekturës së TI, investimeve, modelit të ofrimit, burimet duke përfshirë stafin, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët për të mbështetur objektivat e institucionit.

Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se në strukturën e miratuar të vitit 2021 institucioni kishte një numër total prej 1,366 punonjësish. Në strukturën e mëparshme njësia e teknologjisë së informacionit në UKT ishte e organizuar në nivel sektori në varësi të stafit mbështetës të Drejtorit të Përgjithshëm siç është pasqyruar në figurën e mëposhtme:

Figura nr.1: *Struktura e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, korrik 2021*



*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit*

Struktura e shoqërisë aksionare UKT Sh.A ka pësuar ndryshime nga janari i vitit 2022. Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse i është drejtuar Këshillit të Administrimit të shoqërisë

më një relacion për ndryshime në strukturën organizative dhe organigramën e UKT me shkresën nr. 20514/3, datë 16.11.2021. Për përmbushjen e objektivave institucionale dhe rritjen e kapaciteteve me synim përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit në këtë relacion është propozuar që njësi TI të organizohet në nivel drejtorie. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A ka në strukturën e saj të miratuar nga Këshilli i Administrimit me Vendim nr. 23, datë 26.11.2021 “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, ka një numër total prej 1,376 punonjësish. Drejtoria e Teknologjisë së informacionit është në varësi të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse dhe është e ndarë në dy sektorë përkatësisht Sektori i Sistemit të Pagesave, Database dhe Aplikacioneve dhe Sektori i Infrastruktursë IT. Struktura e funksionimit të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit është e pasqyruar në tabelën e mëposhtme:




Fig. 2: Struktura e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A Janar 2022

Burimi: Të dhëna nga UKT, përpunuar nga grupi i auditimit

Struktura aktuale e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit në shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A është e përbërë nga 8 punonjës, nga të cilët një drejtor drejtorie, 2 (dy) përgjegjës sektori dhe 5 (pesë) specialist. Në Sektorin e Infrastruktursë IT pozicioni i një specialisti Help-Desk është vakant për të cilin institucioni ende nuk ka marrë masa për plotësimin e tij. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur struktura e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit me të dhënat e punonjësve, klasifikimi dhe shkollimi i tyre.

Tabela 1: Struktura e punonjësve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit

Emërtimi i Strukturës		Klasifikimi	Emër Mbiemër	Profili	Shkollimi
Drejtoria IT Drejtor	1	KL 3/2	N. P.	Informatikë	MSH
Sektori i Infrastruktursë IT (Përgjegjës)	1	KN 2/1	A. D.	Sisteme Informatike në Biznes	MSH
Specialist i Sistemeve dhe Rrjeteve	1	KN 2/1	E. H.	Informatikë Ekonomike	BCH
Specialist Help Desk	1	KN 2/2	S. Ç.	Informatikë e Aplikuar	MP
Specialist Help Desk	1		-	-	-
Sektori i Sistemit të Pagesave, Database dhe Aplikacioneve (Përgjegjës)	1	KN 2/1	E. I.	Inxhinieri Elektronike	MSH
Specialist i Aplikacioneve	1	KN 2/1	E. Q.	Teknologji Informacioni	MSH
Specialist i Aplikacioneve	1	KN 2/1	A. G.	Informatikë Biznesi	MP

Burimi i të dhënave: Të dhëna të UKT, përpunuar nga grupi i auditimit

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion. Punonjësit të cilët aksesojnë sistemet e informacionit duhet të jenë të

njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga komunikimet verbale me subjektin është konstatuar se specialistët e TI nuk kanë zhvilluar trajnime për kualifikime profesionale brenda apo jashtë vendit, gjatë periudhës objekt auditimi. Po ashtu, ka rezultuar se institucioni nuk ka një plan mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin stafin në rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre. Mungesa e trajnimeve sipas fushave përkatëse për drejtorinë e teknologjisë së informacionit mund të sjellë mos zbatimin e detyrave të përcaktuara në përshkrimet e punës sipas rregullores së re të miratuar së fundmi në UKT.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, ka rezultuar se UKT nuk disponon regjistër risqesh lidhur me teknologjinë e informacionit. Në asnjë formë nuk rezulton të jenë dokumentuar risqe të identifikuar për periudhën objekt auditimi, por as përpara kësaj. Për veprimet ose mosveprimet që janë në kundërshtim me nenin 11 pika 2 “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.”, 12 pika 3/d “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik, arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”, nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë duhet të kishte hartuar regjistrin e riskut ku të përfshihen në të risqe që lidhen me teknologjinë e informacionit.

**1.Titulli i gjetjes:** UKT nuk disponon strategji të Teknologjisë së Informacionit.

**Situata:** Nga auditimi mbi aktet e brendshëm rregullativë, u konstatua se shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A nuk disponon një strategji institucionale si dhe një strategji mbi teknologjinë e informacionit, mungesa e të cilave sjell mangësi në vendosjen e prioriteteve të institucionit, politikave të sigurisë si dhe përmirësimin e infrastrukturës të TI të cilat do duhet të jenë në mbështetje të objektivave institucionale.

**Kriteri:** Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira të fushës.

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e një strategjie mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucionit.

**Shkaku:** Mos zbatimi i praktikave më të mira në zhvillimin dhe menaxhimin institucional.

**Rëndësia:** E lartë

**1.1.Rekomandimi:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimeve që ofron, duhet të marrë masa për identifikimin, hartimin dhe zhvillimin e elementëve strategjikë në Teknologjinë e Informacionit që mbështesin strategjinë institucionale, ku nevojiten të merren në konsideratë të gjitha proceset për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë.

**2.Titulli i gjetjes:** UKT nuk ka zhvilluar trajnime për rritjen e kapaciteti teknik në strukturën e punonjësve të TI.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se institucioni nuk ka një plan mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin në rritjen profesionale dhe kualifikimin e mëtejshëm

të tyre me qëllim përmbushjen e detyrave në nivel të lartë profesional. Po ashtu, është konstatuar se specialistët e TI nuk kanë zhvilluar trajnime, kualifikime profesionale brenda apo jashtë vendit, gjatë periudhës objekt auditimi.

**Kriteri:** Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira të fushës.

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e trajnimeve sipas fushave përkatëse për drejtorinë e teknologjisë së informacionit mund të sjellë mos zbatimin e detyrave të përcaktuara në përshkrimet e punës sipas rregullores së re të miratuar së fundmi në UKT.

**Shkaku:** Mos zbatimi i praktikave më të mira në zhvillimin dhe menaxhimin institucional.

**Rëndësia:** E mesme

**2.1.Rekomandimi:** Ujësstellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnime profesionale teknike të punonjësve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, si një mënyrë që nxit dhe përmirëson kryerjen e detyrave me nivel të lartë profesional. Trajnimet mbi teknologjinë e informacionit nevojitet të kryhen dhe tek punonjësit e tjerë, duke pasur parasysh elementët më të rëndësishëm si ruajtja e të dhënave, të drejtat dhe detyrimet mbi mjetet teknologjike që disponon institucioni dhe ka vënë në përdorim të punonjësve.

**3.Titulli i gjetjes:** UKT nuk ka identifikuar dhe adresuar rreziqe mbi teknologjinë e informacionit.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se Ujësstellës Kanalizime Tiranë Sh.A nuk disponon regjistër risku për periudhën objekt auditimi lidhur me teknologjinë e informacionit.

**Kriteri:**

- Neni 11, pika 2 “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.”, 12 pika 3/d “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”, nenin 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 23.10.2015.

- Neni 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 23.10.2015, udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, udhëzimi nr.21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

**Ndikimi/efekti:** Nëse nuk identifikohen dhe adresohen risqet në teknologjinë e informacionit atëherë, institucioni do të jetë në kushte ku problematikat do të zgjidhen sipas rastit dhe me kosto të paplanifikuara, por në asnjë rast nuk do të mundet t’i parandalojë ato.

**Shkaku:** Mos njohja e dispozitave ligjore për identifikimin e risqeve në teknologjinë e informacionit.

**Rëndësia:** E lartë

**3.1.Rekomandimi:** Ujësstellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për identifikimin dhe hartimin e regjistrit të riskut lidhur me teknologjinë e informacionit me qëllim identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e tyre, si një mënyrë për të minimizuar problematikat të mundshme që lidhen me teknologjinë dhe përdorimin e saj.

*Në lidhje me këtë pikë të trajtuar nga grupi i auditimit, subjekti nuk ka paraqitur asnjë observacion, për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit.*

### III.2.2 Auditimi i zhvillimit dhe blerjes për teknologjinë e informacionit

UKT ka kryer investime të pakta në Teknologjinë e Informacionit, për periudhën objekt auditimi. Këto investime për vitet 2020, 2021 deri në shtator të vitit 2022, janë mesatarisht 4.5% e investimeve që institucioni ka kryer gjatë kësaj periudhe, ndërsa shpenzimet në TIK zënë më pak se 1% të totalit të shpenzimeve. Informacioni më i detajuar për investimet dhe shpenzimet në këtë drejtim, për periudhën objekt auditimi jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2: Investimet dhe shpenzimet në Teknologjinë e Informacionit nga UKT Sh.A për periudhën objekt auditimi

	2020	2021	2022
Shpenzime UKT (në lekë)	3,370,210,000	3,298,798,121	3,690,526,450
Shpenzime TIK (në lekë)	19,000,000	28,989,166	35,000,000
<b>% e Shpenzimeve</b>	<b>0.56%</b>	<b>0.88%</b>	<b>0.95%</b>
Investime UKT (në lekë)	1,165,616,000	1,103,910,969	786,612,614
Investime TIK (në lekë)	37,496,000	58,250,000	40,332,880
<b>% e Investimeve</b>	<b>3.2%</b>	<b>5.3%</b>	<b>5.1%</b>

Burimi i të dhënave: UKT Sh.A, përpunuar nga grupi i auditimit

#### 2.2.a Procedurat e investimeve në fushën e TIK.

Përzgjedhja e procedurave të prokurimit trajtuar në vazhdimësi është bazuar në kriterin e vlerës më të lartë, duke qenë se investimet në TIK nuk ishin të shumta në numër.

#### 1. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për KNK dhe riparimi i atyre ekzistuese”, me datë zhvillimi të procedurës 30.07.2020 dhe referencë 67463.

Ky projekt ndodhet në regjistrin e planifikimit për vitin 2020 venë në dispozicion të grupit të auditimit.

Në shkresën nr. 4413/3 Prot., datë 27.11.2019 hartuar nga përgjegjësi i sektorit TIK lidhur me shpenzimet në teknologji që planifikon të kryejë shoqëria UKT për vitin 2020, ky planifikim mban emrin: Kompjuterat për KNK dhe rinovim i atyre ekzistuese, në vlerën 10,000,000 lekë pa TVSH.

Tabela 3: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 67463

1. Urdhër Prokurimi: nr. 12491, datë 30.07.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike dhe studimi i tregut: S. K. E. I. S. C.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: L. R. F. V. A. Q.
2. Fondi Limit (pa TVSh) 9,900,000 lekë	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit: I. M. A. Q. A. G.	8. Ndjekësit e kontratës: S. K. L. S. E. Q.
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur/ mallra”	10. Operatori fitues: OE “F.”. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 7,175,000 lekë	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,725,000 lekë
9. Data e hapjes së tenderit: 26.08.2020	12. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: S. CO	13. Operatore të Kualifikuar: 3 (tre)
		14. Operatorë të s’kualifikuar: 1 (një)

B. E. F. PC S.		
<b>15.</b> Ankimimet: Nuk ka	<b>16.</b> Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	<b>17.</b> Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
<b>18.</b> Lidhja e kontratës: nr. 12491/8 Prot, datë 08.10.2020	<b>19.</b> Vlera e kontratës (me TVSh): 8,610,000 lekë	<b>20.</b> Afati i kontratës do të vazhdojë 1 muaj nga data e nënshkrimit.

*Burimi i të dhënave: Dosja elektronike dhe fizike e prokurimit në UKT*

*a. Specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit*

Përgjegjësi i sektorit TIK ka paraqitur kërkesën me nr. 997 Prot., datë 06.03.2020 për kompjutera desktop dhe workstation në sasinë si më poshtë:

- 50 kompjuter Desktop;
- 3 kompjuter Workstation;
- 10 kompjuter Workstation Mini.

Në këtë kërkesë janë përcaktuar specifikimet e pajisjeve dhe theksohet fakti që kompjuterët nevojiten të jenë të fuqishëm, për arsye se do të procesohet GIS dhe Autocad. Specifikat që ka hartuar përgjegjësi i sektorit TIK, i përkasin zërave “Kompjuter Desktop” dhe “Workstation”, por nuk janë dhënë specifika për zërin “Workstation mini”.

Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 85 Prot., datë 04.03.2020, është ngritur grupi i punës i cili do të hartojë specifikimet teknike si dhe studimin e tregut për këtë procedurë.

Për përlllogaritjen e fondit limit, grupi i ngritur ka marrë 3 oferta dhe më datën 05.03.2020 ka hartuar relacionin duke përlllogaritur vlerën limit 9,900,000 lekë pa TVSh, bazuar në pikën 2.a “Çmimet e tregut”, të nenit 59 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në kërkesën e përgjegjësit të TIK nuk është parashtruar asnjë arsye e cila të argumentojë arsyet që kërkohen dy pajisje të ndryshme për nga madhësia “Workstation” dhe “Workstation mini”, por me të njëjtin funksion.

Me urdhrin e prokurimit nr. 12491 Prot., datë 30.07.2020, ka filluar zhvillimi i procedurës me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për KNK dhe rinovim i atyre ekzistuese”, e hapur me fond limit 9,900,000 lekë.

*Nga auditimi u konstatua se:*

- *Kërkesa e përgjegjësit të TIK për zhvillimin e kësaj procedure, është hartuar një ditë pas ngritjes së grupit për hartimin e specifikimeve teknike. Hartimi i specifikimeve nga përgjegjësi i sektorit TIK është një praktikë e përsëritur, ku vetë ky punonjës është anëtar i KVO. Në specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit, nuk gjenden specifikat për njërin nga zërat “Workstation mini”;*
- *Grupi i punës nuk ka hartuar dhe dokumentuar specifikimet teknike përpara se të fillojë studimin e tregut. Gjithashtu, në dokumentet e tenderit që ka publikuar njësisia e prokurimit janë të njëjtat specifika me ato që janë hartuar nga përgjegjësi i sektorit TIK, me të njëjtat mangësi.*
- *Kërkesa për ofertë, drejtuar operatorëve më sipër, për efekt të studimit të tregut nuk përmban asnjë të dhënë teknike mbi çfarë kërkohet përveç emrit të procedurës.*
- *OE kanë bashkëlidhur ofertës specifikime teknike për të gjitha pajisjet në ndryshim me ato që ka hartuar përgjegjësi i sektorit TIK;*
- *Kërkesat për ofertë janë drejtuar tek operatorë ekonomik që janë:*
  - *C. shpk me NIPT .... me shkresën nr.5466, datë 04.03.2020;*
  - *T. S. me NIPT .... me shkresën nr.5468, datë 04.03.2020;*
  - *G.G. me NIPT .... me shkresën nr.5467, datë 04.03.2020.*

*Të tre shoqëritë kanë administrator dhe aksionerë të njëjtët persona, sipas të dhënave të sistemit të QKB.*

- *Grupi i punës ka hartuar relacionin me shkresën nr.485/1, datë 05.03.2020 për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përlllogaritjen e fondit limit. Bashkëlidhur këtij relacioni gjenden specifikimet teknike hartuar nga përgjegjësi i TIK, nisur nga fakti që kanë të njëjtat mangësi, mungesën e specifikimeve për workstation mini, çfarë vërteton faktin se specifikimet nuk janë hartuar nga grupi i punës, por nga përgjegjësi i sektorit TIK.*
- *Nuk është argumentuar dhe nuk është dokumentuar mënyra e zgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit bazuar në specifikimet teknike të objektit që po prokurohet. UKT ka prokuruar në çdo vit pajisje kompjuterike, por në asnjë rast nuk i është referuar çmimeve të kontratave të ngjashme, si një nga mënyrat e përcaktuara në nenin 59, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Për sa më sipër, këto parregullsi janë në kundërshtim me:*

- *Nenin 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku në pikën 4 thuhet se specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, harton specifikimet teknike, në rast se nuk janë hartuar nga struktura të tjera;*
- *Nenin 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku citohet se: “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”;*
- *Urdhrin nr. 85 Prot., datë 04.03.2020 i titullarit të institucionit.*

*Nga auditimi konstatohet se në dokumentet e tenderit janë vendosur specifikime teknike vetëm për pajisjet kompjuter desktop si dhe workstation, ndërsa mungonin specifikimet për workstation mini. Nga APP është kërkuar plotësimi i specifikave që mungojnë nëpërmjet një komunikimi zyrtar të postës elektronike, përgjegjëses së njësisë së prokurimit për këtë procedurë znj.I. M.*

*Nisur nga kërkesa që ka ardhur me email e APP për plotësimin e specifikimeve për produktin “workstation mini”, drejtoria e prokurimeve i është drejtuar përgjegjësit të sektorit TIK z.A.Q. me shkresën nr.2614 Prot., datë 21.08.2020, duke i kërkuar përcaktimin e specifikave që mungojnë duke tejkalluar kompetencat e njësisë së prokurimit dhe duke mos respektuar urdhrin e titullarit të institucionit për grupin e caktuar për hartimin e specifikimeve teknike.*

*Ne përgjigje të kësaj kërkesë, përgjegjësi i sektorit të informacionit dhe teknologjisë ka hartuar specifikat për workstation mini dhe ja ka përcjellë drejtoreshës së prokurimeve znj.L. R., e cila është kryetare KVO për këtë procedurë.*

*Nga auditimi konstatohet se drejtori i prokurimeve dhe përgjegjësi i sektorit TIK, të cilët janë anëtar të KVO-s për këtë procedurë, kanë vepruar në kundërshtim me:*

- *Nenin 57/pikat 2 dhe 4, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;*
- *Nenin 58 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*
- *Urdhrin e titullarit nr.85, datë 04.03.2020 në të cilin janë përcaktuar personat përgjegjës që duhet të hartonin specifikimet teknike për produktet e kërkuara;*
- *Urdhrin e titullarit nr.12491, datë 30.07.2020, që përcakton njësinë e prokurimit;*
- *Urdhrin e titullarit nr.12491/1, datë 30.07.2020, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave;*



Njësia e prokurimit, të cilët kanë hartuar dhe kriteret e veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal, protokolluar me shkresën nr. 12491/2, datë 30.07.2020 në të cilin kanë argumentuar kriteret e vendosura mbi **kapacitetin teknik**, kërkuar si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë 3 viteve të fundit (nga data e zhvillimit të tenderit) me një vlerë sa 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet përkatësisht 3,960,000 lekë pa TVSh.

- Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015 për Menaxhimin e Cilësisë, në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes. Në rast se certifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të përkthyer dhe të noterizuar.

- Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO 27001:2013 për Menaxhimin e sigurisë së informacionit. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes. Në rast se certifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, për objektin e prokurimit për mallin e kërkuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

*Nga auditimi u konstatua se, megjithëse njësia ka pasur në grup një specialist të fushës së informatikës, nuk ka argumentuar teknikisht përse janë të nevojshme kërkesat mbi kapacitetin teknik, në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.*

*Vlerësimi i Ofertave.* Me urdhrin e titullarit nr. 12491/1, datë 30.07.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave që ka për detyrë hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura. Për procedurën e sipërpërmendur, ky komision ka hartuar procesverbalin e vlerësimit në datën 15.09.2020 këtë procedurë prokurimi.

Pjesëmarrës në këtë procedurë kanë qenë këta operatorë ekonomik:

- S. C. sh.p.k me NIPT ....., me ofertë financiare 0 lekë pa TVSh;
- F. me NIPT ....., me vlerë financiare 7,175,000 lekë pa TVSh;
- P. S. me NIPT ....., me vlerë financiare 9,471,000 lekë pa TVSh;
- B. E. me NIPT ....., me vlerë financiare 9,207,900 lekë pa TVSh;

KVO i ka dërguar shkresë me nr. 12491/4, datë 02.09.2020, për sqarim oferte pasi oferta e këtij OE ka rezultuar anomalisht e ulët. OE është përgjigjur duke argumentuar këtë ofertë e cila është marrë në konsideratë nga KVO duke e kualifikuar në vend të parë.

Në datën 15.09.2020 është mbajtur dhe procesverbali i vlerësimit nga KVO për këtë procedurë.

Në përfundim KVO ka vendosur shpalljen fitues të operatorit “F.” me NIPT ....., me vlerë financiare 7,175,000 lekë pa TVSh, i cili që ka përmbushur kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kërkuara në këtë procedurë.

*b. Zbatimi i kontratës*

Me urdhrin e titullarit nr. 354, datë 09.10.2020 është përcaktuar komisioni për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave për kontratën me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për KNK dhe riparimi i atyre ekzistuese”.

50 kompjutera desktop janë marrë në dorëzim me shkresën nr. 354/1, datë 21.10.2020.

3 kompjutera workstation si dhe 10 kompjutera workstation mini janë marrë në dorëzim me shkresën nr. 354/2, datë 30.10.2020.

Afati kohor për zbatimin e kontratës është respektuar dhe është në përputhje me kohën e përcaktuar në kontratë.

**2. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për KNK dhe rinovim i atyre ekzistuese”, me datë zhvillimi të procedurës 26.08.2021 dhe referencë 03925.**

*Ky projekt ndodhet në regjistrin e planifikimit për vitin 2021 venë në dispozicion të grupit të auditimit.*

Në shkresën nr. 3402/6 Prot., datë 23.10.2020 hartuar nga përgjegjësi i sektorit TIK lidhur me shpenzimet në teknologji që planifikon të kryejë shoqëria UKT, për vitin 2021, ky planifikim mban emrin: Kompjuterë për KNK dhe rinovim i atyre ekzistuese si dhe licenca watercad në vlerën 10,000,000 lekë pa TVSH.

*Tabela 4: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 03925*

<b>1.</b> Urdhër Prokurimi: nr. 14868, datë 26.08.2021	<b>3.</b> Hartuesit e specifikimeve teknike dhe llogaritjes së fondit limit: S.K. E.I. S.C.	<b>4.</b> Komisioni i Vlerësimit Ofertave: L.R. E.Q. A.Q.
<b>2.</b> Fondi Limit (pa TVSh) 9,999,999 lekë		
<b>5.</b> Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur, e thjeshtuar”	<b>6.</b> Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kritereve të veçanta: A.Q. A.D. I.M.	<b>7.</b> Komisioni për ndjekjen e kontratës: S.C., L. S., A. Xh.
<b>8.</b> Data e hapjes së tenderit: <b>07.09.2021</b>	<b>9.</b> Operatori fitues: OE “I. S.” sh.p.k. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 7,500,433 lekë	<b>10.</b> Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,499,566 lekë
<b>11.</b> Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: I. S. P. S. C.	<b>12.</b> Operatore të Kualifikuar: 2 (dy)	<b>13.</b> Operatorë të s’kualifikuar: 1 (një)
<b>14.</b> Ankimimet: Nuk ka	<b>15.</b> Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	<b>16.</b> Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
<b>17.</b> Lidhja e kontratës: nr. 14868/7 prot, datë 03.11.2021	<b>18.</b> Vlera e kontratës (me TVSh): 226,382,400 lekë	<b>19.</b> Afati i kontratës do të vazhdojë 90 ditë nga data e nënshkrimit.

*Burimi i të dhënave: Dosja elektronike dhe fizike e prokurimit në UKT*

*a. Specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit*

Përgjegjësi i sektorit TIK ka paraqitur kërkesën me nr. 3424 Prot., datë 19.08.2021 për kompjutera desktop, laptop, workstation si dhe pjesë këmbimi për kompjutera në sasinë si më poshtë:

- 40 copë, kompjuter Desktop;
- 3 copë, Workstation me kasë të vogël;
- 5 copë, Laptop Ekzekutiv;

- 1 copë, Kartë grafike;
- 2 copë, SSD NVME M.2;
- 10 copë, SSD.

Në këtë kërkesë, përgjegjësi i sektorit TIK ka përcaktuar specifikimet e pajisjeve që kërkohen, madje theksohet fakti që kompjuterët nevojiten të jenë të fuqishëm, për arsye se do të procesohet GIS dhe Autocad.

Me shkresën nr. 3424 Prot., datë 19.08.2021, drejtuar drejtorisë së prokurimeve, përgjegjësi i sektorit TIK ka hartuar sasinë e pajisjeve si dhe specifikimet teknike që kërkon. Urdhri për ngritjen e grupit për hartimin e termave dhe studimin e tregut, specifikimet teknike si dhe kërkesa për ofertë drejtuar OE janë dokumente që nuk u gjenden në dosjen fizike të prokurimit.

Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 136 Prot., datë 06.05.2021 është ngritur grupi i punës, i cili do të hartojë specifikimet teknike si dhe studimin e tregut për këtë procedurë.

Ky grup, më datën 16.08.2021 ka marrë 3 oferta dhe ka hartuar relacionin duke përllogaritur vlerën limit bazuar në pikën 2.a “Çmimet e tregut”, të nenit 59 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rezulton të jetë 9,999,999 lekë pa TVSH.

Me urdhrin e prokurimit nr. 14868 Prot., datë 26.08.2021, ka filluar zhvillimi i procedurës me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për KNK dhe rinovim i atyre ekzistuese”, procedurë e hapur e thjeshtuar me fond limit 9,999,999 lekë.

*Nga auditimi u konstatua se:*

- *Kërkesat e hartuara nga përgjegjësi i TIK për pajisjet e kësaj procedure, janë protokolluar me shkresën nr. 3424 në datën 19.08.2021, ose 7 ditë kalendarike pasi operatorët kanë sjellë ofertat. Hartimi i specifikimeve nga përgjegjësi i sektorit TIK është një praktikë e përsëritur, ku vetë hartuesi i tyre është anëtar i KVO;*
- *Grupi i punës nuk ka dokumentuar specifikimet që ka hartuar përpara se të fillojë studimin e tregut;*
- *Kërkesat për ofertë kanë ndjekur të njëjtën praktikë duke u drejtuar tek të njëjtët operatorë ekonomik sikurse edhe në procedurën e zhvilluar një vit më parë, që janë:*
  - *C. sh.p.k me NIPT .... me shkresën nr. 14069/1, datë 12.08.2021;*
  - *T. S. me NIPT .... me shkresën nr. 14068/1, datë 12.08.2021;*
  - *G. G. me NIPT .... me shkresën nr. 14070/1, datë 12.08.2021.*

*Të tre shoqëritë kanë administrator dhe aksionerë të njëjtët persona, sipas të dhënave të sistemit të QKB;*

- *Kërkesa për ofertë, drejtuar operatorëve më sipër, për efekt të studimit të tregut përmban emrin e procedurës, emërtimin e mallrave dhe sasinë e tyre;*
- *Nuk është argumentuar dhe nuk është dokumentuar mënyra e zgjedhur për përllogaritjen e fondit limit bazuar në specifikimet teknike të objektit që po prokurohet;*
- *UKT ka prokuruar në çdo vit pajisje kompjuterike, por në asnjë rast nuk i është referuar çmimeve të kontratave të ngjashme, por në asnjë rast nuk i është referuar çmimeve të kontratave të ngjashme, si një nga mënyrat e përcaktuara në nenin 59, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Në kontratën e mëparshme realizuar në vitin 2020, një kompjuter desktop ka kushtuar 75,300 pa TVSH dhe një workstation mini ka kushtuar 105,800 lekë pa TVSh.

Në rast se përllogaritja e fondit limit do të ishte bazuar në kontratat e mëparshme si një nga mundësitë e parashikuara në dispozitat ligjore, atëherë gjithë vlera e përllogaritur do të ishte si më poshtë:

Tabela 5: Çmime të pajisjeve në procedurën e mëparshme

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Vlera pa TVSH
1	Desktop PC	40	3,012,000
2	Workstation me kasë të vogël	3	317,400
3	Laptop Ekzekutiv	5	1,591,385
4	Kartë grafike	1	204,306
5	SSD NVME M.2	2	20,967
6	SSD	10	80,300
<b>Totali</b>			<b>5,226,358</b>

Burimi i të dhënave: Kontrata e realizuar më parë nga UKT

Pra, nëse do të ishin referuar kontratave të ngjashme sipas pikës 2.b të nenit 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, fondi limit do të ishte 48 % më pak se fondi aktual i përlllogaritur nga grupi.

Për sa më sipër, këto parregullsi janë në kundërshtim me:

- Nenin 36 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- Nenin 2/pika c “Dokumentimi i procesit” në VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Nenin 74, pika 4 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”;
- Nenin 76, pika 2 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Urdhrin nr. 136 Prot., datë 06.05.2021 i titullarit të institucionit.

Njësia e prokurimit, të cilët kanë hartuar dhe kriteret e veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal, me datë 26.08.2021 në të cilin kanë argumentuar dhe kriteret e vendosura mbi **kapacitetin teknik**, kërkuar si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht 1.999.999 lekë pa TVSh.
- Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015 për Menaxhimin e Cilësisë, ose e përditësuar. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marre përsipër sipas akt-marrëveshjes. Në rast se certifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
- Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO 27001:2013 ose e përditësuar për Menaxhimin e sigurisë së informacionit. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes. Në rast se certifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, për mallrat e kërkuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Nga auditimi u konstatua se, megjithëse njësia ka pasur në grup një specialist të fushës së informatikës, nuk ka argumentuar teknikisht përse janë të nevojshme kërkesat mbi kapacitetin teknik, në kundërshtim me nenin 78, pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të

*argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.”.*

*Në procedurën e vitit 2021 paraqitja e kontratave të ngjashme është kërkuar në masën 20% të fondit limit. Kjo vlerë rezulton të jetë maksimalja që përcaktohet në dispozitat ligjore.*

*Vlerësimi i Ofertave.* Me urdhrin e titullarit nr.14868/1, datë 26.08.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave që ka për detyrë hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura, për procedurën e sipërpërmendur, i cili në datën 22.07.2020 ka mbajtur dhe procesverbalin për hapjen e ofertave në këtë procedurë prokurimi.

Pjesëmarrës në këtë procedurë kanë qenë këta operatorë ekonomik:

- P.S. me NIPT ....., me ofertë financiare 7,500,000 lekë pa TVSh;
- I.S. sh.p.k me NIPT ....., me ofertë financiare 7,500,433 lekë pa TVSh.
- C. sh.p.k me NIPT ....., me ofertë financiare 8,098,825 lekë pa TVSh.

Në datën 24.09.2021 është mbajtur dhe procesverbali i vlerësimit nga KVO për këtë procedurë. KVO ka s’kualifikuar operatorin “P.S.” me NIPT ....., me ofertë financiare 7,500,000 lekë pa TVSh, me argumentin se në ofertën ekonomike nuk gjendet një nga zërat e kërkuar në këtë procedurë e konkretisht “SSD”.

Nga verifikimi që u krye gjatë auditimit në sistemin e prokurimit lidhur me ofertën financiare të dërguar nga operatorit pjesëmarrës P.S., u konstatua se argumenti i KVO qendron.

Në përfundim KVO ka vendosur shpalljen fitues të operatorit “I.S.” sh.p.k me NIPT ....., me vlerë financiare 7,500,433 lekë pa TVSh si OE që ka përmbushur kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kërkuara në këtë procedurë dhe është me vlerë më të ulët.

#### *b. Zbatimi i kontratës*

Me urdhrin e titullarit nr. 346, datë 03.11.2021 është përcaktuar komisioni për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave për kontratën me objekt “*Blerje pajisje kompjuterike për KNK dhe riparimi i atyre ekzistuese*”.

3 Workstation me kasë të vogël, 2 SSD NVME, 10 SSD dhe 1 kartë grafike janë marrë në dorëzim me shkresën nr.346/1, datë 28.01.2022.

40 PC të tipit Desktop si dhe 5 Laptop janë marrë në dorëzim me shkresën nr.346/2, datë 31.01.2022.

Afati kohor për zbatimin e kontratës është respektuar dhe është në përputhje me kohën e përcaktuar në kontratë.

Nga auditimi mbi pagesat e kryera për kontratën me objekt “*Blerje pajisje kompjuterike për KNK dhe rinovim i atyre ekzistuese*” dhe vlerë 9,000,520 lekë me TVSH u konstatua se nuk është kryer asnjë pagesë.

### **3. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Rinovim i Suportit të Infrastrukturës Qendrore të UKT Sh.A”, me datë zhvillimi të procedurës 14.05.2020 dhe referencë 58152.**

*Ky projekt ndodhet në regjistrin e planifikimit për vitin 2020 venë në dispozicion të grupit të auditimit.*

Në shkresën nr. 4413/3 Prot., datë 27.11.2019 hartuar nga përgjegjësi i sektorit TIK lidhur me shpenzimet në teknologji që planifikon të kryejë shoqëria UKT, për vitin 2020, ky planifikim mban emrin: Rinovim i suportit të infrastrukturës qendrore në UKT (licenca subscription të network, antivirus spam etj), në vlerën 21,000,000 lekë pa TVSH.

*Tabela 6: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 58152*

1. Urdhër Prokurimi: nr. 11564, datë 20.07.2021	2. Fondi Limit (pa TVSh) 20,996,000 lekë	3. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, shërbim
4. Hartuesit e specifikimeve teknike dhe i llogaritjes së fondit limit: S.K. E.I. S.C.	5. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta: A.Q. K.T. A.G.	6. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: L.R. F.V. A.Q.
7. Data e hapjes së tenderit: <b>08.06.2020</b>	8. Operatori fitues: OE “C.” sh.p.k. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 19,554,000 lekë:	9. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,442,000 lekë
10. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: C. sh.p.k	11. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	12. Operatorë të s’kualifikuar: asnjë
13. Ankimimet: Nuk ka	14. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
16. Lidhja e kontratës: nr. 6883 prot, datë 29.06.2020	17. Vlera e kontratës (me TVSh): 23,464,800 lekë	18. Afati i kontratës do të vazhdojë 12 muaj nga data e nënshkrimit.

*Burimi i të dhënave: Dosja elektronike dhe fizike e prokurimit në UKT*

**a. Specifikimet teknike, përllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit**

Në specifikimet teknike të kësaj procedure kërkohet suporti për server, storage, backup, network, security si dhe platformat software që janë instaluar dhe administrohen në këto pajisje si hyper-v cluster, exchange server 2016, replikimit të domain controller, mirëmbajta dhe monitorim i procesit të Backup-it, etj.

Përgjegjësi i sektorit TIK ka paraqitur kërkesën me nr. 998 Prot., datë 06.03.2020 për rinovim të suportit të infrastrukturës hardwarw dhe software të dhomës së serverëve. Bashkëlidhur kësaj kërkesë gjenden dhe specifikimet teknike qe kërkohen të plotësohen nga kjo procedurë prokurimi.

Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.86 Prot., datë 04.03.2020, është ngritur grupi i punës i cili do të hartojë specifikimet teknike si dhe studimin e tregut për këtë procedurë si dhe të paraqesë rezultatet brenda 3 ditëve.

Për përllogaritjen e fondit limit, grupi i ngritur ka kërkuar oferta tek 3 operatorë ekonomik dhe më datën 05.03.2020 ka hartuar relacionin duke përllogaritur vlerën limit 20,996,000 lekë pa TVSh, bazuar në pikën 2.a “Çmimet e tregut”, të nenit 59 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në kërkesat për ofertë dërguar operatorëve nuk ka asnjë dokument bashkëlidhur dhe informacioni i vetëm që gjendet në dokument është emri i procedurës.

Me urdhrin e prokurimit nr.6883 Prot., datë 22.04.2020, ka filluar zhvillimi i procedurës me objekt “Rinovim i Suportit të Infrastrukturës Qendrore të UKT sha”, e hapur me fond limit 20,996,000 lekë pa TVSH.

*Nga auditimi u konstatua se:*

- Grupi i punës nuk ka hartuar dhe dokumentuar specifikimet teknike përpara se të fillojë studimin e tregut. Hartimi i specifikimeve nga përgjegjësi i sektorit TIK është një praktikë e përsëritur, ku vetë hartuesi i tyre është anëtar i KVO.
- Kërkesa për ofertë, drejtuar operatorëve përmban emrin e procedurës dhe emërtimin e pajisjeve;
- Studimi i tregut është bërë në të njëjtët operatorë ekonomik sikurse edhe në procedurën e zhvilluar një vit më parë, që janë:
  - C. sh.p.k me NIPT .... me shkresën nr.5473, datë 04.03.2020;
  - T.S. me NIPT .... me shkresën nr.5474, datë 04.03.2020;

- *G.G. me NIPT .... me shkresën nr.5472, datë 04.03.2020.*

*Të tre shoqëritë kanë administrator dhe aksionerë të njëjtët persona, sipas të dhënave të sistemit të QKB.*

*Grupi i punës ka hartuar relacionin në zbatim të urdhrit nr. 86 me shkresën nr.86/1, datë 05.03.2020 për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përlllogaritjen e fondit limit.*

*- Nuk është argumentuar dhe nuk është dokumentuar mënyra e zgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit bazuar në specifikimet teknike të objektit që po prokurohet. UKT ka prokuruar në çdo vit rinovim i suportit të infrastrukturës qendrore, por në asnjë rast nuk i është referuar çmimeve të kontratave të ngjashme, si një nga mënyrat e përcaktuara në nenin 59, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Për sa më sipër, këto parregullsi janë në kundërshtim me:*

- Nenin 23 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Nenin 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku në pikën 4 thuhet se specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, harton specifikimet teknike, në rast se nuk janë hartuar nga struktura të tjera;
- Nenin 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku citohet se “Autoriteti Kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”;
- Urdhrin nr. 86 Prot., datë 04.03.2020 të titullarit.

Njësia e prokurimit me shkresën nr.6883/2, datë 14.05.20210 ka mbajtur një procesverbal nëpërmjet të cilit ka dokumentuar argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku për **kapacitetin teknik është kërkuar:**

- Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 8,398,400 lekë pa TVSh të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë ISO 9001:2015, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jete e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që do të marre përsipër sipas akt-marrëveshjes.
- Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 27001:2013 “Për Sigurinë e Informacionit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të shërbimeve që ka marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për secilën pajisje të infrastrukturës qendrore të UKT ku të përshkruhet në mënyrë specifike që Operatori Ekonomik është i autorizuar nga Prodhuesi apo distributori të ofrojë shërbimet e mirëmbajtjes për produktet përkatëse. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

- Operatori ekonomik duhet të jetë Servis i Autorizuar nga Prodhuesi IBM i produkteve Storage apo distributori i autorizuar nga prodhuesi IBM i produkteve Storage. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori duhet të paraqesë Kontratën e Servisit të lidhur me prodhuesin IBM apo me distributorin e autorizuar nga prodhuesi IBM.
  - Operatori ekonomik duhet të jetë Servis i Autorizuar nga Prodhuesi HPE i produkteve Server apo distributori i autorizuar nga prodhuesi HPE i produkteve Server. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori duhet të paraqesë Kontratën e Servisit të lidhur me prodhuesin HPE apo me distributorin e autorizuar nga prodhuesi HPE.
  - Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi HPE në nivelin ekspert për pajisje Server.
  - Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 specialistë të certifikuar nga Prodhuesi IBM për pajisje Storage.
  - Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi Microsoft për Windows Server 2016 në nivelin MCSA.
  - Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi Microsoft për Exchange Server 2016.
  - Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi Microsoft Server Virtualisation.
  - Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi Cisco për pajisje Rrjeti (në nivelin profesional CCNP).
  - Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi HP për pajisje Rrjeti.
  - Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 punonjës në nivelin inxhinier të certifikuar nga Prodhuesi “B” për produktet Next Generation Firewall F.
  - Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 punonjës në nivelin inxhinier të certifikuar nga Prodhuesi “B” për Load Balancer ADC.
- Për të vërtetuar plotësimin e pikave të mësipërme Operatori Ekonomik duhet të paraqesë për çdo punonjës certifikatat përkatëse si dhe listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën janar 2020 - prill 2020.

*Nga auditimi u konstatua se, megjithëse njësia ka pasur në grup një specialist të fushës së informatikës, nuk ka argumentuar teknikisht vlerën prej 40% të kërkuar për kontratat e ngjashme, pikat 3.1, 4, 5 si dhe pikat 9-17 përse janë të nevojshme mbi kapacitetin teknik, në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.*

*Vlerësimi i Ofertave.* Me urdhrin e titullarit nr.11564/1, datë 02.07.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave që ka për detyrë hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura, për procedurën e sipërpërmendur, i cili në datën 22.07.2020 ka mbajtur dhe procesverbalin për hapjen e ofertave në këtë procedurë prokurimi.

Pjesëmarrës në këtë procedurë kanë qenë dy operatorë ekonomik:

- C. sh.p.k me NIPT ....., me vlerë financiare 19,554,000 lekë pa TVSH;

Në përfundim KVO ka vendosur shpalljen si fitues të operatorit të vetëm pjesëmarrës.

**b. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi**

Për marrjen në dorëzim apo ndjekjen mbi zbatimin e kësaj kontrate, nuk ka pasur një grup të ngritur dhe as raport mbi realizimin, por fatura e shërbimit është përcjellë me shkresë nga përgjegjësi i sektorit të TIK, i cili verifikonte shërbimin e kryer.



**4. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Rinovim i Suportit të Infrastrukturës Qendrore të UKT sha”, me datë zhvillimi të procedurës 07.02.2021 dhe referencë 99961.**

*Ky projekt ndodhet në regjistrin e planifikimit për vitin 2021 venë në dispozicion të grupit të auditimit.*

Në shkresën nr. 3402/6 Prot., datë 23.10.2020 hartuar nga përgjegjësi i sektorit TIK lidhur me shpenzimet në teknologji që planifikon të kryejë shoqëria UKT, për vitin 2021, ky planifikim mban emërtimin: Rinovim i suportit të infrastrukturës qendrore në UKT (licensa subscription të network, antivirus spam etj), në vlerën 21,000,000 lekë pa TVSH.

*Tabela 7: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 99961*

<b>1.</b> Urdhër Prokurimi: nr. 11564, datë 20.07.2021	<b>2.</b> Fondi Limit (pa TVSh) 20,850,000 lekë	<b>3.</b> Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, shërbim
<b>4.</b> Hartuesit e specifikimeve teknike dhe llogaritjes se fondit limit: S.K. E.I. S.C.	<b>5.</b> Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta: A.Q. K.T. A.D.	<b>6.</b> Komisioni i Vlerësimit Ofertave: L.R. A.Q. E.Q.
<b>7.</b> Data e hapjes së tenderit: <b>21.07.2021</b>	<b>8.</b> Operatori fitues: OE “C.” sh.p.k. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 19,309,800 lekë:	<b>9.</b> Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,540,200 lekë
<b>10.</b> Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: i.C. sh.p.k C. sh.p.k	<b>11.</b> Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	<b>12.</b> Operatore të s’kualifikuar: 1 (një)
<b>13.</b> Ankimimet: Nuk ka	<b>14.</b> Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	<b>15.</b> Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
<b>16.</b> Lidhja e kontratës: nr. 11564/7 Prot. datë 11.08.2021	<b>17.</b> Vlera e kontratës (me TVSh): 23,171,760 lekë	<b>18.</b> Afati i kontratës do të vazhdojë 12 muaj nga data e nënshkrimit.

*Burimi i të dhënave: Dosja elektronike dhe fizike e prokurimit në UKT*

**a. Specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit**

Me anë të kësaj procedure, UKT ka kërkuar të prokurojë blerjen e garancive dhe licencave për mbështetje teknike të infrastrukturës qendrore ekzistuese me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në 99.9%, kjo në bazë të përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore” në të gjithë komponentët dhe shërbimet e ofruara nga ky sistem. Komponentët kryesore të infrastrukturës janë:

**Infrastruktura Hardware**

- HPE Blades Chassis & Servers
- HP Storage
- HPE Networking
- IBM Storage
- CISCO Networking
- BARRACUDA Networking

**Infrastruktura Software**

- Windows OS
- Exchange Mail Server

Përgjegjësi i sektorit IT, me anë të shkresës nr. 2553, datë 24.06.2021, ka kërkuar rinovim të suportit të infrastrukturës hardware dhe software të dhomës së serverëve. Bashkëlidhur kësaj

kërkese gjenden dhe specifikimet teknike që kërkohen të plotësohen nga kjo procedurë prokurimi.

Nga auditimi u konstatua se në dosjen e prokurimit nuk gjendet urdhri i ngritur për grupin që ka hartuar specifikimet teknike dhe ka kryer studimin e tregut, kërkesat për ofertë që i drejtohen operatorëve si dhe relacioni i mbajtur nga grupi për fondin limit.

Ky dokumentacion është kërkuar në protokoll së bashku me kërkesat për ofertë drejtuar OE me qëllim përlllogaritjen e fondit limit.

*Nga auditimi u konstatua se:*

- Grupi i punës nuk ka hartuar dhe dokumentuar specifikimet teknike përpara se të fillojë studimin e tregut. Hartimi i specifikimeve nga përgjegjësi i sektorit TIK është një praktikë e përsëritur, ku vetë hartuesi i tyre është anëtar i KVO.

- Kërkesa për ofertë, drejtuar operatorëve më sipër, për efekt të studimit të tregut nuk përmban asnjë të dhënë teknike mbi çfarë kërkohet përveç emrit të procedurës dhe emërtimit të pajisjeve, ndërsa oferta e tyre përmban specifikat teknike për çfarë kërkohet.

- Kërkesat për ofertë janë drejtuar tek të njëjtët operatorë ekonomik sikurse edhe në procedurën e zhvilluar një vit më parë, që janë:

- C. sh.p.k me NIPT .... me shkresën nr.9642, datë 07.06.2021;
- T. S. me NIPT .... me shkresën nr.9641, datë 07.06.2021;
- G. G. me NIPT .... me shkresën nr.9640, datë 07.06.2021.

Të tre shoqëritë kanë administrator dhe aksionerë të njëjtët persona, sipas të dhënave të sistemit të QKB.

- Grupi i punës ka hartuar relacionin në zbatim të urdhrit nr. 138 me shkresën nr.138/1, datë 18.06.2021 për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përlllogaritjen e fondit limit.

- Nuk është argumentuar dhe nuk është dokumentuar mënyra e zgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit bazuar në specifikimet teknike të objektit që po prokurohet. UKT ka prokuruar në çdo vit rinovim i suportit të infrastrukturës qendrore, por në asnjë rast nuk i është referuar çmimeve të kontratave të ngjashme, duke mos respektuar në këtë mënyrë nenin 59, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Për sa më sipër, këto parregullsi janë në kundërshtim me:*

- Nenin 36 "Specifikimet teknike", të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik";
- Nenin 2/pika c "Dokumentimi i procesit" në VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";
- Nenin 74, pika 4 "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit";
- Nenin 76, pika 2 "Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit", në VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";
- Urdhrin nr. 138 Prot., datë 07.05.2021 të titullarit.

Në datën 02.07.2021 njësia e prokurimit, ka mbajtur një procesverbal nëpërmjet të cilit ka dokumentuar argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku për **kapacitetin teknik është kërkuar:**

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate ose 8.340.000 lekë pa TVSh.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë **ISO 9001:2015.0**, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që do të marre përsipër sipas akt-marrëveshjes.

- Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 27001:2013 “Për **Sigurinë e Informacionit**”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që do të marre përsipër sipas akt-marrëveshjes.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për secilën pajisje të infrastrukturës qendrore të UKT ku të përshkruhet në mënyrë specifike që Operatori Ekonomik është i autorizuar nga Prodhuesi apo distributori të ofrojë shërbimet e mirëmbajtjes për produktet përkatëse. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
- Operatori ekonomik duhet të jetë Servis i Autorizuar nga Prodhuesi IBM i produkteve Storage apo distributori i autorizuar nga prodhuesi IBM i produkteve Storage. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori duhet të paraqesë Kontratën e Servisit të lidhur me prodhuesin IBM apo me distributorin e autorizuar nga prodhuesi IBM.
- Operatori ekonomik duhet të jetë Servis i Autorizuar nga Prodhuesi HP i produkteve Server apo distributori i autorizuar nga prodhuesi HP i produkteve Server. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori duhet të paraqesë Kontratën e Servisit të lidhur me prodhuesin HP apo me distributorin e autorizuar nga prodhuesi HP.

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi HPE për pajisje Server.
- Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 specialistë të certifikuar nga Prodhuesi IBM për pajisje Storage.
- Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi Microsoft për Windows Server 2016 në nivelin MCSA.
- Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi Microsoft për Exchange Server 2016.
- Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi Microsoft Server Virtualisation.
- Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi Cisco për pajisje Rrjeti (në nivelin profesional CCNP).
- Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi HP për pajisje Rrjeti.
- Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 punonjës të certifikuar nga Prodhuesi BARRACUDA për produktet Next Generation Firewall F.

*Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratën e punës
- b) Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- c) Punonjësit e sipërcituar duhet të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit (Mars 2021- Maj 2021).

*Nga auditimi u konstatua se, megjithëse njësia ka pasur në grup një specialist të fushës së informatikës, nuk ka argumentuar teknikisht kërkesat mbi kapacitetin teknik duke filluar me vlerën prej 40% të kërkuar për kontratat e ngjashme si dhe punonjësit e certifikuar me CCNP,*

MCSA etj, në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Megjithëse në specifikimet teknike është kërkuar suporti për “Application Delivery Controller /Load Balancer”, në kapacitetin teknik nuk është kërkuar një punonjës me certifikim në Barracuda Load Balancer, sikurse në procedurën e vitit të kaluar, që do tregon se certifikimi nuk është domosdoshmëri për mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve.

Nga auditimi konstatohet se, kriteret e veçanta të kualifikimit në lidhje me kapacitetin teknik janë të njëjta me ato të vendosura në procedurën e zhvilluar një vit më parë me të njëjtin objekt prokurimi.

**Duke qenë në kushte të njëjta teknike të prokurimit të një mirëmbajtje atëherë përlllogaritja e fondit limit mund të bazohet në kontratat e ngjashme parashikuar në dispozitat ligjore të prokurimit publik.**

*Vlerësimi i Ofertave.* Me urdhrin e titullarit nr.11564/1, datë 02.07.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave që ka për detyrë hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura, për procedurën e sipërpërmendur, i cili në datën 22.07.2020 ka mbajtur dhe procesverbalin për hapjen e ofertave në këtë procedurë prokurimi.

Pjesëmarrës në këtë procedurë kanë qenë dy operatorë ekonomik:

- i.C. me NIPT ....., me ofertë financiare 19,100,000 lekë pa TVSH;
- C. sh.pk me NIPT ....., me vlerë financiare 19,309,800 lekë pa TVSH;

OE i.C. shp.k është s’kualifikuar me argumentin se nuk ka paraqitur formularin e sigurimit të ofertës si dhe formularin përmbledhës të vetë deklarimit sipas shtojcës 9, çfarë është në kundërshtim me kërkesat e DST.

Nga verifikimi që u krye gjatë auditimit në sistemin e prokurimit lidhur me dokumentacionin e OE të s’kualifikuar, u konstatua se argumenti i KVO qendron.

Në përfundim KVO ka vendosur shpalljen fitues të operatorit të vetëm pjesëmarrës C. me NIPT ....., me vlerë financiare 19,309,800 lekë pa TVSH.

#### *b. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi*

Për marrjen në dorëzim apo ndjekjen mbi zbatimin e kësaj kontrate, nuk ka pasur një grup të ngritur, por fatura e shërbimit është përcjellë me shkresë nga përgjegjësi i sektorit të TIK, ku thuhet se shërbimi është kryer.

Nga auditimi mbi numrin e licencave të suportit kërkuar për vitin 2020 janë të njëjta me ato të kërkuara në vitin 2021. Ndërsa, licencat e suportit kërkuar në vitin 2021 nuk janë të njëjta me ato të vitit 2022. Në vitin 2022 janë shtuar disa licenca për Servera Blade, Switch SAN, Switch ETHERNET, ndërkohë që nuk është ofruar licencë për një pajisje Cisco SmartNet NBD. Nuk kemi asnjë argumentim në shtimin dhe pakësimin e numrit të licencave, apo informacion se pse është rritur ky numër dhe situatën mbi pajisjen që nuk ofrohet me support.

### **5. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Blerje Aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatëseve”, me datë zhvillimi të procedurës 12.06.2020 dhe referencë 61141.**

*Tabela 8: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 61141*

1. Urdhër Prokurimi: nr. 9435, datë 10.06.2021	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: S.K. E.I. S.C.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: L.R. A.Q. F.V.
2. Fondi Limit (pa TVSh) 7,780,500		

5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, shërbim	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta: D.Gj. A.Q. A.G.	7. Komisioni për marrjen në dorëzim: B.T. E.I. E.K.
8. Data e hapjes: <b>25.06.2020</b>	9. Operatori fitues: J. S.. Vlera e ofertës fituese, pa TVSh, 7.572,500 lekë:	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 208,000 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: J. S.	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të s’kualifikuar: S’ka
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: nr.9435/8 prot, datë 15.07.2020	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 9,087,000 lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë 20 ditë nga data e nënshkrimit.

*Burimi i të dhënave: Dosja elektronike dhe fizike e prokurimit në UKT*

a. *Hartimi i specifikave teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit* Me shkresën nr. 999 Prot., datë 06.03.2020, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të prokurimeve, është paraqitur kërkesa nga Përgjegjësi i sektorit IT për:

- 130 Telefona/PAD;
- 26 Licenca për software lexim matje faturimi- AI-Billing AMS Mob 4.4.4.

Në bazë të urdhrin nr. 92 Prot., datë 04.03.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit.

Me shkresën nr. 492/1 Prot., datë 05.03.2020 relacion për marrje oferte, drejtuar operatorëve ekonomik nga UKT Sh.A, është kërkuar dorëzimi i ofertave me qëllim përlllogaritjen e fondit limit. Fondi limit i përlllogaritur nga grupi i është referuar mesatares së 3 ofertave të marra nga tregu, konkretisht 7,780,500 lekë pa TVSh.

Me shkresën nr. 9435 Prot., datë 10.06.2020 Drejtoria e Prokurimeve, urdhëron kryerjen e Prokurimit me fond limit 7,780,500 lekë pa TVSh, me objekt “Blerje Aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatësve”. Njësia e prokurimit, të cilët kanë hartuar dhe kriteret e veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal, protokolluar me shkresën nr. 9435/2, datë 10.0.2020 në të cilin kanë argumentuar kriteret e vendosura mbi **kapacitetin teknik**, kërkuar si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 3,112, 200(tre milion e njëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind) lekë pa TVSh të realizuar gjatë tri viteve të fundit(përlllogaritur nga data e zhvillimit të tenderi).

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërpërmendur operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate.

Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat tatimore të shitjes të nënshkruar nga të dyja palët ku të shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

2.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë ISO 9001- 2015 (e vlefshme),lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Certifikata kërkohet të jete e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që do të marre përsipër sipas akt-marrëveshjes.)

2.5 Shoqëria duhet te paraqesë Certifikatën e Sigurisë së Informacionit ISO 270001 (e vlefshme), apo e standardit të përditësuar. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marre përsipër sipas akt-marrëveshjes.)

2.6. Operatori ekonomik duhet te paraqesë:

Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, për objektin e prokurimit për mallin e kërkuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.7. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë në sistemin elektronik katalogun/et/datasheet të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi. Në rast se katalogët apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe sipas legjisllacionit në fuqi.

2.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë nga 1 (një) mostër të mallrave objekt prokurimi. Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për s kualifikim.

2.9. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi jo më pak se 2 (dy) punonjës inxhinierë/specialist të fushës IT (elektronikë/ teknologji informacioni/,inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatike/ inxhinieri informatike).

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Me urdhrin nr. 9435/1 datë 10.06.2020 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Nga auditimi në sistemin elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt u konstatua se në tender ka marrë pjesë dhe është kualifikuar vetëm operatori “J.S”, me ofertë ekonomike 7.572,500 lekë pa TVSH.

*Nga auditimi u konstatua se:*

- Grupi për hartimin e specifikimeve teknike është ngritur 1 ditë para se të bëhej kërkesa për këtë procedurë nga përgjegjësi i TIK;
- Grupi i ngritur me urdhër të titullarit nuk ka hartuar dhe dokumentuar specifikimet teknike përpara se të fillojë studimin e tregut;
- Kërkesa për ofertë për efekt të studimit të tregut, drejtuar operatorëve, nuk përmban specifikime teknike mbi çfarë kërkohet;
- Njësia nuk ka argumentuar teknikisht nevojën mbi kërkesat e vendosura për kapacitetin teknik.

*b. Zbatimi i kontratës*

Me urdhrin e brendshëm nr.248, datë 15.07.2020 është përcaktuar komisioni për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave për kontratën me objekt “Blerje aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatëseve”.

Me shkresën nr.U-248/1, datë 21.10.2020 grupi ka marrë në dorëzim pajisjet, të cilët përmbushin specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës.

Afati kohor për zbatimin e kontratës është respektuar dhe është në përputhje me kohën e përcaktuar në kontratë.

**6. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Blerje Aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatëseve”, me datë zhvillimi të procedurës 01.09.2021 dhe referencë 04290.**

Tabela 9: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 04290

<b>1.</b> Urdhër Prokurimi: nr. 15224, datë 01.09.2021	<b>3.</b> Komisioni i llogaritjes së fondit limit: E.Q. E.I. S.C.	<b>4.</b> Hartuesit e Dokumenteve të tenderit dhe kritereve të veçanta: A.D. A.Q. K.T.
<b>2.</b> Fondi Limit (pa TVSh) 7,796,035		
<b>5.</b> Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar-mallra	<b>6.</b> Komisioni i Vlerësimit Ofertave: L.R. A.Q. N. P.	<b>7.</b> Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 521,785 lekë
<b>8.</b> Data e hapjes së tenderit: <b>01.09.2021</b>	<b>9.</b> Operatori fitues: CCS sh.p.k Vlera e ofertës fituese, pa TVSh, 7,274,250 lekë:	<b>10.</b> Operatorë të s'kualifikuar: S'ka
<b>11.</b> Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: CCS sh.p.k	<b>12.</b> Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	<b>13.</b> Lidhja e kontratës: Nr15224/7 Prot., datë 04.10.2021
<b>14.</b> Ankimimet: Nuk ka	<b>15.</b> Vlera e kontratës (me TVSh): 8,729,100 lekë	<b>16.</b> Afati i kontratës 60 dite.

Burimi i të dhënave: Dosja elektronike dhe fizike e prokurimit në UKT

*a. Specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit*

Me shkresën nr. 3523 Prot., datë 25.08.2021, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të prokurimeve, është paraqitur kërkesa nga Përgjegjësi i sektorit IT, për Blerje aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatësve në sasinë 53 copë.

Në bazë të urdhrin nr. 252 Prot datë 09.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës, për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit.

Me shkresën nr. U252/1 Prot., datë 19.08.2021 relacion për marrje oferte, drejtuar operatorëve ekonomik nga UKT Sh.A, është kërkuar dorëzimi i ofertave me qëllim përlllogaritjen e fondit limit. Fondi limit është përlllogaritur nga grupi, referuar mesatares së 3 ofertave të marra nga tregu, konkretisht 7,796,035 lekë.

Me shkresën nr. 15224 Prot., datë 01.09.2021, Drejtoria e Prokurimeve urdhëron kryerjen e prokurimit me fond limit 7,796,035 lekë, me objekt “Blerje Aparate reader për kryerjen e lexime të ujëmatësve”. Ndërsa Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është ngritur me Urdhrin nr.15224/1 datë 01.09.2021.

Argumentimi i specifikimeve teknike dhe fondit limit është bërë me anë të procesverbalit që mban datën 01.09.2021.

*Kapaciteti teknik:*

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht 1.559, 207(një milion e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSh.

- Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015 për Menaxhimin e Cilësisë, ose e përditësuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes. Në rast se certifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

*Nga auditimi u konstatua se:*

- Grupi për hartimin e specifikimeve teknike është ngritur 1 ditë para se bëhej kërkesa nga përgjegjësi i TIK, për këtë procedurë;

- Grupi i punës nuk ka hartuar dhe dokumentuar specifikimet teknike përpara se të fillojë studimin e tregut;
- Kërkesa për ofertë për efekt të studimit të tregut, drejtuar operatorëve, nuk përmban specifikime teknike mbi çfarë kërkohet;
- Njësia e prokurimit, nuk ka argumentuar teknikisht pse janë të nevojshme kërkesat mbi kapacitetin teknik.

Për sa më sipër, këto parregullsi janë në kundërshtim me:

- Nenin 36 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- Nenin 2/pika c “Dokumentimi i procesit” në VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Nenin 74, pika 4 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”;
- Nenin 76, pika 2 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Urdhrin nr. 136 Prot., datë 06.05.2021 i titullarit të institucionit.

Zhvillimi i procedurës. Nga auditimi në sistemin elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatësve 2021”, u konstatua se në tender ka marrë pjesë 1 operator “CCS” me ofertë financiare 7,274,250 lekë pa TVSH. KVO ka kryer vlerësimin dhe e ka shpallur fitues.

**Rekomandime të APP.** Për këtë procedurë APP nëpërmjet një email-i drejtuar drejtuesve të UKT ka dhënë disa rekomandim për subjektin:

- Përcaktimet e specifikimeve teknike duhet të jenë në gjuhën shqipe;
- Parametrat specifikë nuk duhen kërkuar me specifikime fikse për të shmangur orientimin drejt markave specifike;
- Çdo kriter i veçantë duhet argumentuar teknikisht dhe ligjërisht;

UKT shpall fitues operatorin e vetëm pjesëmarrës CCS Sh.p.k për objektin “Blerje aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatësve” me të cilin nënshkruan dhe kontratën me nr.15224/7 datë 04.10.2022.

Me shkresën nr. 15224/12, Autoriteti Kontraktor UKT Sh.A dhe Kontraktori CCS Sh.p.k, kryejnë zgjidhjen e kontratës me kërkesën e nisur nga UKT me arsyen se:

Zhvillimet e fundit në teknologjinë e informacionit të paparashikuara në implementimin e sistemit të Billingut se bashku me softuerë e leximeve na detyron që të shtyjmë integrimin e telefonave me Software-in e ri. Magazinimi i tyre do sillte degradim të baterive dhe vetë telefonave pasi bateria e tyre kërkon kushte specifike të magazinimit të cilat UKT sha nuk i disponon. Magazinimi i tyre do na sillte një kosto të lartë. Për këtë arsye kërkojmë anulimin e kësaj kontrate për ta ribërë pas implementimit të Software-it të Billingut në periudhën 2022. Na auditimi u konstatua se nuk ka një argumentim të arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës.

## 7. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Blerje Aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatësve”, me datë zhvillimi të procedurës 05.04.2022 dhe referencë 27362.

Tabela 10: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 27362

1. Urdhër Prokurimi: nr. 8693, datë 04.05.2022	2. Fondi Limit (pa TVSh) 7,773,333 lekë	3. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar.
4. Komisioni i specifikime teknike dhe llogaritjes se fondit limit: A. D. A. Ç. A.D.	5. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta: E. H. A.Q. K.T.	6. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: L.R. E. M. N. P.



<b>7.</b> Data e hapjes së tenderit: 27.05.2022	<b>8.</b> Ndjekësit e kontratës: E. H. S.C. E.Q.	<b>9.</b> Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,473,333 lekë
<b>10.</b> Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: “P. A. sh.p.k “A.S.S” sh.p.k “L” sh.p.k “A” sh.p.k “L”	<b>11.</b> Operatori fitues: “A.S.S ” sh.p.k Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 6,300,000 lekë:	<b>12.</b> Operatorë të s’kualifikuar: “P. A. sh.p.k “L” sh.p.k “L”
	<b>13.</b> Operatore të Kualifikuar: A.S.S. sh.p.k “A”	<b>14.</b> Lidhja e kontratës: nr.8693/24 Prot., datë 23.08.2022
<b>15.</b> Ankimimet: po	<b>16.</b> Vlera e kontratës (me TVSh): 7,560,000 lekë	<b>17.</b> Afati i kontratës 3 muaj.

*Burimi i të dhënave: Dosja elektronike dhe fizike e prokurimit në UKT*

*a. Specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit*

Me shkresën nr.1518 Prot, 20.04.2022 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të prokurimeve, është paraqitur kërkesa nga Drejtori i IT, për blerje aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatësve në sasinë 80 copë.

Në bazë të urdhrin nr. 09 Prot, datë 13.01.2022 të Drejtorisë së faturimit është ngritur grupi i punës i përbërë për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit.

Me shkresën nr. U09/1 Prot, datë 15.04/2022 relacion për marrje oferte, drejtuar operatorëve ekonomik nga UKT Sh.A, është kërkuar dorëzimi i ofertave me qëllim përlllogaritjen e fondit limit. Grupi i Posaçëm i Punës, ka përcaktuar fondin limit, referuar mesatares së 3 ofertave të marra nga tregu, konkretisht 7,773,333.

Me shkresën nr. 8693 Prot datë 04.05.2022 Drejtoria e Prokurimeve urdhëron kryerjen e Prokurimit me fond limit 7,773,333 lekë pa TVSH me objekt “Blerje Aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatësve”.

*Kriteret e veçanta të kualifikimit:*

– Operatori Ekonomik duhet të disponoje certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e vlefshme lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

– Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor . Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

– Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në sistemin elektronik katalogun/et/ ose fragmente të katalogut të prodhuesit të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të prodhuesit. Në rast se katalogët apo skedat teknike janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi.

– Katalogu ose skedat teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të artikullit të kërkuar me qëllim që AK të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara.

– Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë të garancisë të mallit të ofruar sipas përcaktimeve në shtojcën e specifikimeve teknike.

*Nga auditimi u konstatua se:*

- *Hartimi i specifikimeve është kërkuar nga Departamenti i shitjes, që të kryhet nga përgjegjësi i sektorit TIK i cili nuk është anëtar i asnjë prej strukturave të krijuara, në kundërshtim me nenin 74, pika 4 i VKM.nr 285, Datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

- Nuk është argumentuar mënyra e zgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit bazuar në specifikimet teknike të objektit që po prokurohet.

Me urdhrin nr. 8693/1 datë 04.05.2022 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i cili ka bërë vlerësimin si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa TVSH)	Vlerësimi i KVO-së
1	“P. A. sh.p.k	7,274,250	S’kualifikuar
2	A.S. S. sh.p.k	6,300,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues
3	“L” sh.p.k	7,260,000	S’kualifikuar
4	“A” sh.p.k	7,468,000	Kualifikuar
5	“L”	7,580,600	S’kualifikuar

Me datë 30.05.2022 është depozituar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga operatori ekonomik pjesëmarrës “A.S. S.” sh.pk si dhe për Autoritetin Kontraktor në portalin elektronik e-albania në seksionin e KPP.

Pas depozitimit të ankesës të operatorit ekonomik Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i ngritur me urdhër nr. 8693/5, datë 30.05.2022 (në vijim KSHA) mori në shqyrtim ankesën në mbështetje të nenit 114 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 101 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nga të cilët u konkludua se ankesat e depozituara në Autoritetin Kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik përpara datës të publikimit të njoftimit të fituesit, konsiderohen të paraqitura përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar për të paraqitur ankesë.

KPP ka gjykuar se ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor në datën 30.05.2022, si dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në datën 30.05.2022, konsiderohen e paraqitura përpara afatit ligjor të ankimit, Në nenin 118, pika 2, germa "a" të nr.162/2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar parashikohet se: "Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të refuzojë ankesën, për shkak mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të këtij ligji". Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit.

#### b. Zbatimi i kontratës

Me urdhrin e brendshëm nr. 262, datë 23.08.2022 është përcaktuar komisioni për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave për kontratën me objekt “Blerje aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatëseve”.

Me shkresën nr. U-248/1, datë 21.10.2020 grupi ka marrë në dorëzim pajisjet, të cilët përmbushin specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës.

Afati kohor për zbatimin e kontratës është respektuar dhe është në përputhje me kohën e përcaktuar në kontratë.

### 8. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Shërbim fotokopje me të tretë”, me datë zhvillimi të procedurës 25.11.2020 dhe referencë 79997.

Tabela 11: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 79997

1. Urdhër Prokurimi: nr. 19756, datë 25.11.2020	2. Fondi Limit (pa TVSh) 21,978,333	3. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur, Shërbim marrëveshje kuadër
---	-------------------------------------	--

<b>4.</b> Komisioni i specifikime teknike dhe llogaritjes se fondit limit: S.K. E.I. S.C.	<b>5.</b> Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta: D. Gj. A.Q. S.K.	<b>6.</b> Komisioni i Vlerësimit Ofertave: L.R. A.Q. F.V.
<b>7.</b> Data e hapjes së tenderit: <b>25.11.2020</b>	<b>8.</b> Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: -I. O. -BO "P.S." Sh.p.k & R.	<b>9.</b> Operatori fitues: BO "P.C" Sh.p.k & R. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 20,562,500 lekë:
<b>10.</b> Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,415,833 lekë	<b>11.</b> Operatorë të s'kualifikuar: I.O.	<b>12.</b> Operatore të Kualifikuar: 1 (një)
<b>11.</b> Operatorë të s'kualifikuar: I.O.	<b>12.</b> Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	<b>13.</b> Lidhja e kontratës: nr.19756/16 Prot., datë 01.12.2021
<b>14.</b> Ankimimet: Nuk ka	<b>15.</b> Vlera e kontratës (me TVSh): 24,675,000lekë	<b>16.</b> Komisioni i marrjes në dorëzim E.I. A.Q. .S.C.

*Burimi i të dhënave: Dosja elektronike dhe fizike e prokurimit në UKT*

*a. Specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit*

Me shkresën nr. 3700 Prot., 18.11.2020 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të prokurimeve, është paraqitur kërkesa dhe specifikime teknike nga Përgjegjësi i sektorit IT për shërbim fotokopje me të tretë.

Në bazë të urdhrin nr. 377/1 Prot., datë 17.11.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës, për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit. Grupi i punës ka marrë tre oferta në treg dhe ka llogaritur çmimin mesatar për njësi. Totali i vlerës së parashikuar është 21,978,333 lekë pa TVSh.

Me shkresën nr. 19756 Prot., datë 25.11.2020 Drejtoria e Prokurimeve urdhëron kryerjen e Prokurimit me fond limit 21,978,333 lekë pa t.v.sh me objekt "Shërbim fotokopje me të tretë" Me Proces-Verbalin nr. 19756/2 Prot., datë 25.11.2020, njësia e prokurimit paraqet dokumentet e tenderit.

*Kapaciteti teknik:*

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë 3 viteve të fundit (nga data e zhvillimit të tenderit) me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose 8,971,333 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSh.

- Kur shërbimi i ngjashëm i mëparshëm është realizuar me institucione shtetërore. Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.

- Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me subjekte private. Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore ku të jetë shënuar datat, shuma, të nënshkruar nga të dyja palët.

**3.4. Operatori ekonomik duhet te paraqesë:**

Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, për pajisjet që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit të printimit.

Ne rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë

të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose broshura të prodhuesit/ve të pajisjeve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit. Në rast se katalogët apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe, dhe të noterizuara sipas legjislacionit në fuqi. Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të produkteve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit.

3.6. Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të zërave që e kanë të domosdoshëm montimin dhe konfigurimin, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij 6 muajt e fundit punonjës inxhinierë/specialistë/ teknikë të fushës IT (të pajisur me certifikimet e mëposhtme:

- 1 (një) specialist të certifikuar PMI ose ekuivalente për menaxhimin e projektit;
- 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional për sistemin e menaxhimit të politikave të sigurisë dhe aksesit në rrjet ose ekuivalente;
- 3 (tre) specialistë IT të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve që ofron për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë zbatimit të kontratës;
- 2 (dy) inxhinierë ose specialiste të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve që oferton për software monitorimi të ofertuar për të implementuar, konfiguruar, integruar dhe suportuar përgjatë kontratës;
- 1 (një) inxhinier IT të certifikuar për servera/ storage për të gjithë konfigurimet e nevojshme në infrastrukturën e serverave/storage të Autoritetit;
- 1 (një) punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Expert për Desktop Infrastrukture ose ekuivalente për të implementuar dhe integruar me zgjidhjen ekzistuese për të gjithë pajisjet;

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Për inxhinierët, diploma përkatëse, kontratë pune, certifikatat si më sipërcituar;
- Për specialistët ose teknikët, kontratë pune, certifikatat si më sipërcituar;
- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën maj 2020 – tetor 2020;
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën maj 2020 – tetor 2020.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente, lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 27001:2013 ose ekuivalente mbi Sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, lëshuar nga organi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO/ IEC 20000-1:2011 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të shërbimeve lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes.

Nga auditimi u konstatua se:

- Grupi i ngritur me urdhër të titullarit nuk ka hartuar dhe dokumentuar specifikimet teknike përpara se të fillojë studimin e tregut. Për hartimin e specifikimeve teknike është ndjekur e njëjta praktikë duke u përgatitur nga përgjegjësi i sektorit TIK, ku vetë ky punonjës është anëtar i KVO për këtë procedurë;
- Kërkesa për ofertë për efekt të studimit të tregut, drejtuar operatorëve, nuk përmban specifikime teknike mbi çfarë kërkohet;
- Njësia nuk ka argumentuar teknikisht nevojën mbi kërkesat e vendosura për kapacitetin teknik, në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Zhvillimi i procedurës. Me Urdhrin nr.19756/1 datë 25.11.2020 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Nga auditimi në sistemin elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatësve 2021”, u konstatua se në tender ka marrë pjesë operatorët:

- I.O.;

Ky OE nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertë ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në DST;

- BO "P.S. dhe R.;

Ky OE ka marrë pjesë me ofertë financiare 20,562,500 dhe është kualifikuar nga KVO pasi përmbush të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Zbatimi i kontratës:

Me urdhrin e titullarit nr. 80, datë 02.03.2021 është përcaktuar komisioni për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave për kontratën me objekt “Shërbim fotokopje me të tretët”,. Pagesat janë kryer pas situacioneve të sjella nga operatori Ekonomik.

Në lidhje me këtë pikë të trajtuar nga grupi i auditimit, subjekti nuk ka paraqitur asnjë observacion, për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit.

## 2.2.b Marrëveshjet e nivelit të shërbimit (Service Level Agreement-SLA).

### 1. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Mirëmbajtje sistem Billing”, me datë zhvillimi të procedurës 10.07.2020 dhe referencë 74292.

Ky projekt ndodhet në regjistrin e planifikimit për vitin 2020 venë në dispozicion të grupit të auditimit.

Planifikimi për këtë shpenzim mban emërtimin: Mirëmbajtje software lexim faturim (UKT reader) dhe webservice në vlerën 8,000,000 lekë.

Tabela 12: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 74292

1. Urdhër Prokurimi: nr. 16613, datë 07.10.2020		4. Hartuesit e specifikimeve teknike dhe llogaritjes së fondit limit:
2. Fondi Limit (pa TVSh) 8.000,000 lekë	3. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, shërbime	S.K. E.I. S.C.
5. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: L.R. A.Q. F.V.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta: A.Q. I.M.	7. Ndjekësit e kontratës: S.Ç. E. K. E.Q.

	A.G.	
<b>8.</b> Data e hapjes së tenderit: <b>02.11.2020</b>	<b>9.</b> Operatori fitues: OE “K.” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 4,900,000 lekë:	<b>10.</b> Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 3,100,000 lekë
<b>11.</b> Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: K. I.S. & I.B.S.	<b>12.</b> Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	<b>13.</b> Operatorë të s’kualifikuar: 1 (një)
<b>14.</b> Ankimimet: K. I.	<b>15.</b> Përgjigje Ankesës nga AK Nr.20381/1, datë 15.12.2020 Nr.2614/1, datë 18.02.2021	<b>16.</b> Përgjigje Ankesës nga KPP: Nr.66/1, datë 04.02.2021 Nr. 152/1, datë 07.04.2021
<b>17.</b> Lidhja e kontratës: nr. 16613/16 Prot., datë 14.05.2021	<b>18.</b> Vlera e kontratës (me TVSh): 5,880,000 lekë	<b>19.</b> Afati i kontratës do të vazhdojë 12 muaj nga data e nënshkrimit.

*Burimi i të dhënave: Dosja elektronike dhe fizike e prokurimit në UKT*

a. *Specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit*  
UKT ka pasur dhe ka ende dy sisteme ndërtuar dhe funksional që në thelb kanë pasur të njëjtin qëllim, atë të faturimit. Emërtimet e sistemeve janë Microsoft NAV 2013 dhe Billing.

Përgjegjësi i sektorit IT, me anë të shkresës nr. 3122, datë 30.09.2020, ka kërkuar zhvillimin e procedurës për mirëmbajtjen vjetore të sistemit të faturimit Microsoft Dynamics Navision - NAV. Bashkëlidhur kësaj kërkesë gjenden dhe specifikimet teknike të sistemit që kërkohen të arrihen nga operatori fitues i kësaj procedurë prokurimi.

*Nga auditimi u konstatua se planifikimi i fondeve ishte për sistemin e faturimit Billing, Reader dhe Webservice, por specifikimet teknike që janë hartuar nga përgjegjësi i sektorit të TIK të cilat janë marrë në konsideratë nga njësia e prokurimit, janë hartuar për sistemin tjetër të faturimit NAV 2013 i cili nuk është vënë në funksion. Të dhënat që gjenden në të janë importuar nga sistemi aktual funksional i faturimit që përdor UKT që quhet Billing.*

Grupi i punës ka hartuar relacionin në zbatim të urdhrin nr. 296 me shkresën nr.269/1, datë 22.09.2020 i cili është dokumenti që tregon për testimin e tregut dhe përlllogaritjen e fondit limit.

*Nga auditimi u konstatua se:*

- *Grupi i punës nuk ka hartuar dhe dokumentuar specifikimet teknike përpara se të fillojë studimin e tregut.*
- *Specifikimet teknike që ka marrë në konsideratë njësia e prokurimit që gjenden tek dokumentet e tenderit janë hartuar nga përgjegjësi i sektorit TIK.*
- *Kërkesa për ofertë, drejtuar operatorëve më sipër, për efekt të studimit të tregut nuk përmban asnjë të dhënë teknike mbi çfarë kërkohet, por vetëm emrin e procedurës.*
- *Nuk është argumentuar përlllogaritja e fondit limit.*

*Për sa më sipër, këto parregullsi janë në kundërshtim me:*

- Neni 36 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”;
- Neni 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku në pikën 4 thuhet se specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, harton specifikimet teknike, në rast se nuk janë hartuar nga struktura të tjera;
- Neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku citohet se “Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave”.

- Nenin 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku citohet se “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”;
- Urdhrin nr. 296 Prot., datë 01.09.2020 të titullarit.

*Nga auditimi mbi specifikimet teknike pjesë e dokumenteve të tenderit, u konstatua se:*

*Në paragrafin nr.9 “Kërkesat funksionale” citohet se “Në vijim të projektit të realizuar për implementimin Microsoft Dynamics NAV 2013, dhe ngritjen e platformës së re për sistemin e faturimit, arkëtimit dhe menaxhimin e financës së institucionit, nevojiten që ky sistem i rëndësishëm të mirëmbahet dhe azhurnohet sipas kërkesave dhe zhvillimeve më të fundit të aplikuara nga legjislacioni dhe rregulloret në fuqi”.*

*Në paragrafin 1.3 “Situata aktuale në sektor” të specifikimeve teknike jepet informacion vetëm për sistemin Microsoft Dynamic NAV 2013 si dhe funksionalitet që janë implementuar në këtë platformë.*

*Në paragrafin 2.1 “Objektivi i përgjithshëm” i specifikimeve teknike thuhet se qëllimi i kësaj kontrate është si më poshtë:*

- *Mirëmbajtja dhe azhurnimi i sistemit të menaxhimit financiar, arkëtimit dhe faturimit në UKT;*
- *Mirëmbajtja dhe suport teknik për funksionalitetet e implementuar në platformën Microsoft Dynamics NAV 2013;*

*Por mungon informacioni mbi situatën aktuale të sistemit të faturimit.*

*Në paragrafin 6.1 “Kërkesat për Raportimin” kërkohen:*

- Raport fillestar prej 12 faqesh;
- Draft Raporti përfundimtar;
- Raporti final;
- Raporte mujore.

*Ky model raportimi ndiqet në rastet kur zhvillohet një sistem i ri dhe jo një mirëmbajtje.*

Njësia e prokurimit me anë të shkresës nr.16613/2 Prot., datë 07.10.2020 ka dokumentuar argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit. Për **kapacitetin teknik është kërkuar:**

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë 3 viteve të fundit (nga data e zhvillimit të tenderit) me një vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose 3,200,000 lekë pa TVSh.

- Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 27001:2013 “Për Sigurinë e Informacionit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të shërbimeve që ka marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit. Në rast se certifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik ta paraqesë të përkthyer dhe të noterizuar sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.

- Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 9001:2015 “Për Menaxhimin e Cilësisë”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të shërbimeve që ka marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit. Në rast se certifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik ta paraqesë të përkthyer dhe të noterizuar sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.

- 1 specialist të certifikuar Analist Biznesi Software (Software Business Analyst) i pajisur me certifikimin/ trajnimin përkatës i cili duhet të rezultojë në listë pagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit Korrik- Shtator shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/ inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë/ inxhinierike softwerike.

*Nga auditimi u konstatua se ky kriter jo vetëm që është i paargumentuar, por i panevojshëm për sa kohë do të prokurohet mirëmbajtja 12 mujore e një sistemi ekzistues dhe azhurnimet e kërkuara janë pjesë e specifikimet teknike dhe të identifikuara nga vetë punonjësit e UKT. Pra, kjo kërkesë tejkalon kërkesat e dokumentuara për realizimin e kontratës.*

- 1 specialist të certifikuar për zhvillim software i pajisur me certifikimin/ trajnimin përkatës i cili duhet të rezultojë në listë pagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit korrik-shtator shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë/ inxhinierike softwerike.

*Nga auditimi u konstatua se ky kriter jo vetëm që është i paargumentuar, por dhe shumë i përgjithshëm kur objekti i prokurimit si dhe specifikimet teknike, janë hartuar për mirëmbajtjen e një sistemi ekzistues në një platformë të njohur ndërkombëtare Microsoft Dynamics NAV 2013. Në kushtet kur kërkohen të mirëmbahen dy sisteme të cilat funksionojnë në platforma të ndryshme do të duhej të kërkohej një specialist për secilën prej tyre.*

- 1 specialist të certifikuar për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të sistemit bazuar mbi teknologjinë MS SQL ose ekuivalente i pajisur me certifikimin/ trajnimin përkatës i cili duhet të rezultojë në listë pagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit korrik- shtator shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/ inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë/ inxhinierike softwerike.

*Nga auditimi u konstatua se ky kriter i referohet platformës Microsoft Dynamics NAV 2013 ndërkohë që baza e të dhënave aktuale dhe në përdorim që disponon UKT është në Oracle. Kriteri për specialist të certifikuar në Oracle DB nuk është bërë pjesë e kriterëve. Në kushtet kur kërkohen të mirëmbahen dy sisteme të cilat funksionojnë me databaza të ndryshme do të duhej të kërkohej një specialist databaze për secilën prej tyre, rrjedhimisht me certifikimin përkatës.*

- 1 specialist të certifikuar për pajisjet Server të sistemit i pajisur me certifikimin/ trajnimin përkatës i cili duhet të rezultojë në listë pagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit korrik - shtator shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/ inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë/ inxhinierike softwerike.

- 1 specialist të certifikuar për platformën e virtualizimit të përdorur në datacenterin e UKT i pajisur me certifikimin/ trajnimin përkatës i cili duhet të rezultojë në listë pagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit korrik - shtator shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/ inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë/ inxhinierike softwerike.

Për punonjësit e sipërpërmendur operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimeve elektronike kontratën e punës (të vlefshme), listë pagesat për periudhën Korrik 2020 - Shtator 2020, diplomat përkatëse, certifikatat/ trajnimin përkatës si dhe Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore.

*Kriteri i vendosur në çdo rast për diplomë në fushën IT teknologji informacioni/ inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë/ inxhinierike softwerike, është gjithashtu i paargumentuar dhe nuk cenon realizimin e kontratës kur paralelisht me këtë janë kërkuar certifikime përkatëse.*



Gjithashtu kriteri ku specialistët e kërkuar të jenë në listë pagesat 3 muajt e fundit është një kriter i paargumentuar dhe nuk e cenon arritjen e objektivit të kontratës.

*Nga auditimi mbi kriteret e vendosura për kapacitetin teknik u konstatua se nuk janë argumentuar teknikisht. Mangësitë në argumentimin teknik të kërkesave të vendosura mbi kapacitetin teknik, janë në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.*

*Vlerësimi i Ofertave.* Me urdhrin e titullarit nr.16613/1, datë 07.10.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave që ka për detyrë hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura, për procedurën e sipërpërmendur, i cili me anë të shkresës nr.16613/2, datë 07.10.2020 ka dokumentuar procesverbalin e mbajtur nga KVO për hapjen e ofertave në këtë procedurë prokurimi.

Pjesëmarrës në këtë procedurë kanë qenë dy operatorë ekonomik:

- K. me NIPT ....., me ofertë financiare 4,900,000 lekë pa TVSH;
- BOE I.S & I.B.S. me NIPT ... & ....., me vlerë financiare 7,568,000 lekë pa TVSH;

OE K. ka depozituar në sistemin elektronik të prokurimit një ofertë anomalisht të ulët për të cilin KVO ka kërkuar argumentimin përpara vlerësimit.

Argumentimi i OE nuk e ka bindur KVO, e cila ka vlerësuar këtë ofertë si të pavlefshme me argumentin se nuk është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 56, të LPP-së, duke e konsideruar dokumentacionin e këtij operatori të paplotë.

Si përfundim KVO ka shpallur ofertë të vlefshme vetëm BOE I. S. & I. B. S. si OE që ka përmbushur kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kërkuara në këtë procedurë.

Për këtë vlerësim është paraqitur ankesa e operatorit K., i cili ka fituar të drejtën të mos s’kualifikohet nga KPP nëpërmjet vendimit nr.66/1, datë 04.02.2021.

Me përfundimin e rivlerësimit të OE pjesëmarrës nga KVO, një ankesë është paraqitur dhe nga OE I.S. pjesëmarrës në BOE I.S & I.B.S. Vendimi nr. 152/1, datë 07.04.2021 i KPP-s nuk i ka dhënë të drejtë operatorit mbi argumentet që paraqit në trajtën e ankesës.

Në përfundim të ankesave të cilat kanë rezultuar me vendimet përkatëse të KPP, OE pjesëmarrës renditen si më poshtë:

- K. me NIPT .... dhe ofertë financiare 4,900,000 lekë pa TVSH;
- BOE I.S & I.B.S. me NIPT ... & .... dhe ofertë financiare 7,568,000 lekë pa TVSH.

Bazuar në këtë renditje OE fitues është K. me NIPT .....

#### *b. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi*

Me urdhrin e titullarit nr.149, datë 14.05.2021 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave për kontratën “*Mirëmbajte system Billingu*”.

Nga auditimi mbi mënyrën e raportimit të OE u konstatua se nuk është raportuar në përputhje me paragrafin 6.1 “Kërkesat e Raportimit” të specifikimeve teknike në DST.

Në dokumentacionin e dorëzuar si raport mujor periodik janë dokumentuar se janë kryer shërbimet për:

- Kontroll të parametrave fizikë të serverëve dhe përdorimit të burimeve CPU, RAM në server;
- Kontroll i hapësirës së lirë;
- Verifikim i komponentëve;
- Monitorim i performancës së shërbimeve të instaluara në server.

Në specifikimet teknike të cilat janë pjesë e kontratës, OE është kërkuar të realizohen shërbime azhurnimi të sistemit të faturimit dhe menaxhimit financiar:

- Shtim i fushave të reja te kartela e abonentit. Fushat do të merren parasysh për përllogaritjen e taksës së pronës.
- Importimin e të dhënave të pronës nga moduli i deklarimit online të pronës në sistemin NAV.
- Shtim i disa Fusha/Funksione në modulin e ankesave.
- Përgatitja e formulave të nevojshme për përllogaritjen e taksës së pronës.
- Importi i të dhënave të pronave nga file i vënë në dispozicion (të dhëna të kadastrës).
- Shtim i pikave të arkëtimit në sistem, si dhe i përdoruesve të profilit Arkë respektivisht për çdo pikë.
- Shtim i raporteve të reja dhe modifikim i atyre ekzistuese lidhur me taksën e pronës
- Azhurnimi i të dhënave në sistemin NAV.

Për të verifikuar modulet e konfiguruar që mirëmbahen në sistemin Microsoft NAV 2013 kërkuam tek sektori IT të aksesojmë këtë platformë, me qëllim për të verifikuar të dhënat e importuara nga sistemi Billing, por nuk rezulton të jetë vendosur në kapacitet të plotë.

Akt kolaudimet janë nënshkruar nga grupi i ndjekjes së kontratës, por nga auditimi mbi raportet mujore periodike dorëzuar nga OE u konstatua se:

- Kontrollat e dokumentuara me raportet periodike përmbajnë kontrole parandaluese;
- Raportimi periodik nuk rezultoi të ketë dokumentuar shërbime azhurnimi si dhe shërbime mirëmbajtje për sistemin e faturimit dhe menaxhimit financiar, për sistemin NAV 2013 apo Billing.

Për sa më sipër, mban përgjegjësi grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës.

**1.Titulli i Gjetjes:** Parregullsi në hartimin e specifikimeve teknike, dokumentimin e fondit limit, argumentimin e kriterëve të veçanta si dhe dokumentimin e raporteve periodike të mirëmbajtjes.

**Situata:** Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit zhvilluar në drejtim të teknologjisë së informacionit për pajisje kompjuterike, licenca dhe mirëmbajtje, u konstatua se:

- Specifikimet teknike që janë bërë pjesë e dokumenteve të tenderit, nuk janë hartuar nga grupet e ngritura për këtë qëllim dhe në përputhje me dispozitat ligjore si dhe urdhrat e brendshëm.
- Metoda e përdorur për përllogaritjen e fondit limit, bazuar në çmimet e tregut nuk është dokumentuar dhe argumentuar plotësisht në përputhje në përcaktimet e dispozitave ligjore.
- Kërkesat e vendosura mbi kapacitetin teknik nuk janë argumentuar nga ana teknike, por vetëm nga ana ligjore, çfarë është në kundërshtim me nenin 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikuar në nenin 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
- Raportet periodike të mirëmbajtjes nuk janë dokumentuar në përputhje me specifikimet teknike që janë pjesë integrale e tyre.

**Kriteri:**

- Neni 59 “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku citohet se “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”;
- Neni 76, pika 2 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, në VKM nr.285, datë 19.05. 21, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Neni 2/pika c “Dokumentimi i procesit” në VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;

- Neni 61, pika 2 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
- Neni 36 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”;
- Neni 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku në pikën 4 thuhet se specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, harton specifikimet teknike, në rast se nuk janë hartuar nga struktura të tjera;
- Urdhrat e brendshëm për secilën prej procedurave.

**Ndikimi/Efekti:** Procedura të realizuara me mangësi në zbatim të ligjit të prokurimit si dhe dispozitave ligjore që rrjedhin prej tij.

**Shkaku:** Mungesa e njohurive ligjore mbi zbatimin e ligjit të prokurimit publik si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

**Rëndësia:** E lartë

**1.1 Rekomandimi:** Ujësuellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për:

- Hartimin e specifikimeve teknike në prokurime të teknologjisë së informacionit, të cilat duhet të dokumentohen dhe argumentohen për çdo procedurë, përpara përllogaritjes së fondit limit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ky dokument të nevojitet të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.
- Njësia përgjegjëse për prokurimet në teknologjinë e informacionit, në përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, të marrë në konsideratë specifikime teknike të hartuara nga strukturat e ngritura për këtë qëllim. Në rastet e mungesës së kësaj strukture, specifikimet teknike përllogaritja e fondit limit, kapaciteti teknik, grafiku i lëvrimit apo hartimi i kritereve, nevojiten të hartohen nga vetë njësia.
- Dokumentimin dhe argumentimin e mënyrës së zgjedhur në llogaritjen e fondit limit, për procedura të zhvilluara për teknologjinë e informacionit. Ky dokument të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.
- Argumentimin teknik dhe ligjor të çdo kërkesë të vendosur në kapacitetin teknik, për procedurat e prokurimit që lidhen me teknologjinë e informacionit. Ky dokument të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.
- Ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të shërbimeve të mirëmbajtjes në teknologjinë e informacionit, në përputhje me kërkesat e parashikuara në specifikimet teknike, duke dokumentuar në këtë mënyrë të plotë gjurmën e shërbimit të realizuar nga ofruesi.

**1.2 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor, Ujësuellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për përzgjedhjen dhe zhvillimin e trajnimeve specifike të zyrtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit si dhe për raste të veçanta të kërkojë nga APP mendime paraprake për trajnimin e tyre me qëllim realizimin e procedurave në vijimësi në përputhje me dispozitat ligjore.

*Në lidhje me këtë pikë të trajtuar nga grupi i auditimit, subjekti nuk ka paraqitur asnjë observacion, për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit.*

### III.2.3. Auditimi i Sistemeve

- Verifikim i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output.*
- Përdoruesit e sistemeve, të drejtat dhe gjurmët e veprimeve në sistem.*

Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion grupit të auditimit, UKT ka implementuar disa sisteme informatike, të cilat janë:

*Sistemi i leximit të matësve.* Me anë të këtij sistemi bëhet e mundur mbledhja e leximeve për të gjithë matësit e abonentëve të UKT. Sistemi përbëhet nga software qendror që është i instaluar në server në data center dhe nga aplikacioni mobile që instalohet në pajisjet mobile që përdorin lexuesit e UKT. Me anë të ndërfaqes qendrore, caktohen matësit që do të lexojë çdo lexues. Aplikacioni mobile që përdorin lexuesit sinkronizohet me serverin dhe merr matësit që duhet të lexohen dhe dërgon në sistemin e faturimit leximet e kryera.

*Sistemi i taksave.* UKT nëpërmjet këtij sistemi përlllogarit taksat që mbledh për llogari të bashkisë. Sistemi i taksave është integruar në sistemin e faturimit dhe arkëtimeve për të dërguar taksat e llogaritura tek ky i fundit.

*Sistemi i faturimit.* Ky sistem realizon procesin e faturimit dhe arkëtimin e faturave mujore të ujit. Fatura është e miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Sistemi ndërlidhet me sistemin e leximeve dhe taksave për të llogaritur faturën mujore për çdo abonent.

Nga auditimi mbi sistemet informatike që disponon UKT u konstatua se, të dhënat e abonentëve, matësve si dhe faturim-arkëtimin e administron me sistemin informatik “Billing”, por nuk disponon asnjë nga dokumentacionet e mëposhtme:

- Rregullore mbi përdorimin;
- Manual përdorimi;
- Diagramet e qarkullimit të informacionit;
- Kodin në burim;
- Dokumentacion udhëzues i ndërtimit.

Me kërkesë të Departamentit të Shitjes, sektori IT kryen disa ndryshime manuale në sistemin e faturimit që janë:

- *Faturat zbritëse.* Veprimet lidhur me faturat zbritëse kryhen nga ndërfaqja e sistemit të faturimit Billing.

- *Anulim faturash.* Veprimet e anulimit kryhen nga ndërfaqja i sistemit të faturimit.

*Për veprimet e mësipërme lidhur me faturat zbritëse si dhe Anulimet, gjenerohet një raport monitorimi i cili quhet “Sistemime Memo” që përmban veprimet e kryera, i cili monitorohet nga Departamenti i Shitjes.*

- *Shtim Vlerë rilidhje ujëmatësi* për tipin e faturimit “me frymë”. Kjo vlerë faturimi nuk shtohet dot nga ndërfaqja e sistemit, pasi bëhet fjalë për faturimet me frymë. Me qëllim mbledhjen e kësaj vlere shtohet nga back-end rekordi.

- *Ndryshim në emrin e Abonentit.* Veprimet për ndryshimin e emrit të abonentit për periudha të faturimit të shkuar kryhen në bazën e të dhënave, ndërsa ndryshimet në emrin e Abonentit për faturimet e së ardhmes kryhen nga ndërfaqja e sistemit.

Nga auditimi mbi veprimet operationale që kryhen direkt në bazën e të dhënave u konstatua se Drejtoria TIK vepron lidhur me kërkesat për:

- *Shtim Vlerë rilidhje ujëmatësi* për tipin e faturimit “me frymë”. Kjo vlerë faturimi nuk shtohet dot nga ndërfaqja e sistemit, pasi bëhet fjalë për faturimet me frymë. Me qëllim shtimin e kësaj vlere shtohet rekordi në tabelën përkatëse.

- *Ndryshim në emrin e Abonentit.* Veprimet për ndryshimin e emrit të abonentit për periudhat e faturimit të së ardhmes kryhen nga ndërfaqja e sistemit, ndërsa ndryshimi i emrit të abonentit për periudhat e faturimit të shkuar kryhen në bazën e të dhënave nga Drejtoria e TIK.

Departamenti i Shitjes dërgon tek IT kërkesën për të kryer ndryshime të emrit të abonentit në sistem. Në këtë dokument nuk përcaktohet me saktësi koha, por ndryshimet kërkohen sipas periudhës debitore. Periudha debitore është një informacion i cili nevojitet të verifikohet më parë nga ndërfaqja e sistemit, përpara se të kryejë ndryshimet në bazën e të dhënave

Gjatë periudhës në auditim janë raportuar nga IT disa problematika me sistemin e faturim – arkëtimin “Billing”:

1. Gjatë mbylljes së periudhës së faturimit për muajin nëntor 2021, është konstatuar se është shfaqur “error” gjatë ekzekutimit të procedurës “u\_llogarit\_kompensim” për përjashtim nga taksat e bashkisë të abonentëve me status “pensionist”. Ky ekzekutim nuk mund të kryhej pasi disa kolona tek tabela e kompensimeve ishin bërë “drop”, pra ishin hequr nga tabela. Për këto veprime nuk ka asnjë gjurmë se cili përdorues e ka kryer dhe në cilën kohë e ka kryer.

Ky problem është raportuar tek personi i kontaktit i cili ka ndërtuar sistemin Billing pasi OE i cili ka ofruar mirëmbajtjen nuk ka gjetur dot zgjidhjen. Për të vijuar me ekzekutimin e procedurës janë shtuar kolonat që mungonin.

Nga auditimi u konstatua se problematika e raportuar nga IT tek OE i cili ofronte mirëmbajtjen e sistemit NAV dhe Billing nuk ka gjetur zgjidhje. Në mungesë të zgjidhjes për këtë çështje, është kontaktuar personi që ka ndërtuar sistemin e Billing i cili ka dhënë zgjidhje duke krijuar tabelat dhe procedurat nga fillimi dhe që mbajnë datën 3.12.2021. Megjithëse problemi është zgjidhur për efekt të përlllogaritjes së kompensimit, ai nuk është zgjidhur për nga ana e sigurisë sepse ‘drop’ të kolonave mund të ndodhë në çdo moment dhe pa asnjë gjurmë, çfarë cenon sigurinë e data bazës dhe të dhënave që gjenden në të.

Me kryerjen e backup-it periodik të bazës së të dhënave, proces i kontraktuar tek palët e treta, UKT mund të kishte kthyer të dhënat e fshira, por në asnjë rast kthimi i të dhënave nga backup nuk është testuar dhe nuk është përdorur, megjithëse në këtë rast ka qenë e nevojshme.

2. Faturimet e një abonenti rezultuan të jenë fshirë. Nga verifikimet mbi të dhënat për këtë abonent, ka rezultuar se nuk ka pasur fatura të gjeneruar në data basë për periudhën Janar 2019-Nëntor 2021.

Nga verifikimet në përdoruesit e bazës së të dhënave u konstatua se janë aktiv përdoruesit: K., T., U., UKT\_R., UKT\_O., UKT\_K..

*Nga auditimi mbi përdoruesit e bazës së të dhënave u konstatua se Drejtori i IT disponon dy përdorues në bazën e të dhënave që janë UKT\_R. dhe UKTO.. Ndërsa përdoruesit K., UKT\_O. dhe UKT\_K. janë përdorues të krijuar nga operatori ekonomik K. dhe nën administrimin e tij, megjithëse kontrata e shërbimit me UKT ka përfunduar në maj të vitit 2022. Nuk ka asnjë gjurmë dokumentare të aksesit që ky OE ka në bazën e të dhënave dhe përse disponon më shumë se 1 përdorues.*

Nga auditimi mbi privilegjet apo të drejtat e përdoruesve të bazës së të dhënave u konstatua se përdoruesit e OE K.kanë të drejta për:

- të eksportuar gjithë bazën e të dhënave;
- të krijuar tabela, procedura, funksione, sinonime, etj.;
- të ekzekutuar procedura, funksione, etj.;
- të hequr çdo tabelë, indekse etj.

*Për sa më sipër, siguria e të dhënave dhe e vetë strukturës së bazës së të dhënave paraqitet me risk të lartë të ndërhyrjeve të paautorizuara.*

Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion të grupit të auditimit, lista e shërbimeve që ofron UKT është si në vijim:

- Ankesa Online (<https://online.ukt.al/ankese.php>);
- Shfaqja e faturës online për çdo abonent që ka llogari te UKT shfaqet në faqen <http://online.ukt.al>;
- Debia e abonentëve dhe pagesa nëpërmjet bankave (lidhja me VPN me bankat);
- Pagesave nëpërmjet palëve të treta që kanë kontratë me UKT Sh.A (lidhja me VPN + Webservice).

Në kushte të mungesës së dokumentacionit të ndërtimit të sistemit Billing, mungesës së dokumentimit të proceseve të punës që realizohen nëpërmjet sistemit, mungesës së gjurmës elektronike për veprimet e përdoruesve, *nuk mund të shprehemi nëse të dhënat e sistemit Billing janë të sigurta.*

**1.Titulli i Gjetjes:** Mangësi në dokumentacion dhe akte rregullative mbi përdorimin dhe funksionimin e sistemeve informatike.

**Situata:** Nga auditimi mbi sistemet informatike që disponon Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A, u konstatua se të dhënat e abonentëve, matësve si dhe faturim-arkëtimin e administron me sistemin informatik “*Billing*”, por nuk disponon asnjë nga dokumentacionet e mëposhtme:

- Rregullore mbi përdorimin e sistemit;
- Rregullore operacionale mbi veprimet sistemuese që kryhen në sistem dhe bazën e të dhënave;
- Manual përdorimi;
- Diagramet e qarkullimit të informacionit;
- Kodin në burim;
- Dokumentacion udhëzues i ndërtimit.

**Kriteri:** Dokumentimi i sistemit informatik në të cilin kryhen veprime Input/Output.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e dokumentacionit udhëzues mbi ndërtimin e sistemit, funksionimin e tij, qarkullimin e informacionit, kodin në burim, janë gjurmë që mungojnë dhe kjo mungesë krijon pamundësi për të audituar veprimtarinë dhe mbarëvajtjen e sistemit informatik.

**Shkaku:** Mungesë njohurish dhe vëmendje mbi rëndësinë e dokumentimit të zhvillimit të sistemit informatik, punonjësit e larguar.

**Rëndësia:** E lartë

**1.1 Rekomandim:** Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e rregullores dhe manualit të përdorimit për sistemin informatik të faturim-arkëtimin në të cilat të përcaktohen detyrimet dhe rëndësia e veprimeve në këtë sistem, për çdo përdorues punonjës të institucionit që e akseson atë. Gjithashtu, të dokumentohen diagramet e qarkullimit të informacionit për secilin nga proceset që nis dhe përfundon nëpërmjet sistemit informatik të faturim - arkëtimin, duke siguruar në këtë mënyrë gjurmën e proceseve që kryhen nëpërmjet sistem.

**1.2 Rekomandim:** Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e rregullores për veprimet operacionale, që nevojitet të kryhen në sistemin informatik për efekte sistemuese të shkaktuara nga gabimet njerëzore apo pamundësitë e njohura të sistemit nëpërmjet ndërfaqeve të sistemit. Për secilin prej ndryshimeve të parashikuara në rregullore të hartohen dhe miratohen formatet që sigurojnë gjurmën e veprimeve të kryera dhe të autorizuara sipas nevojës. Në këtë rregullore mund të përfshihen gjithashtu veprimet operacionale për pezullim të përkohshëm apo të përhershëm të aksesit të përdoruesve të jashtëm, dokumentimi i lidhjeve të reja, monitorimin periodik, që tregojnë për nivelin e aksesimit në sistemin informatik nga palët e treta që ofrojnë shërbime faturim – arkëtimin, për llogari të institucionit.

**2.Titulli i Gjetjes:** Gjurma mbi veprime që kryhen direkt në databazë si dhe gjurma për veprimet e përdoruesve.

**Situata:** Nga auditimi mbi gjurmën elektronike të auditimit u konstatua se nuk gjenerohet gjurmë mbi veprimet që kryejnë përdoruesit e bazës së të dhënave.

Për përdoruesit e sistemit nga ndërfaqja, ruhen të dhëna të pakta që janë: hyrja, dalja, IP e përdoruesit si dhe mënyra e daljes nga sistemi. Kjo gjurmë elektronike është e pamjaftueshme, për të siguruar të dhëna mbi aktivitetin e tyre. Në të dhënat e faturimit për periudhën objekt auditimi u konstatua vetëm në një rast për një kontratë të caktuar, mungojnë rekordet e faturimit, çfarë tregon mundësinë për ndërhyrje në bazën e të dhënave.

**Kriteri:** Mungesa e konfigurimeve të nevojshme për plotësimin e gjurmës elektronike të auditimit (Audit Logs) në sistemin Billing.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e kësaj gjurmë auditimi, vështirëson vet kontrollin apo auditimin e ndryshimeve që janë kryer nga ndërfaqja apo nga baza e të dhënave. Risk për humbje apo tjetërsim të të dhënave.

**Shkaku:** Mungesa e politikave, akteve rregulluese dhe monitoruese mbi mbrojtjen e të dhënave, mungesa e konfigurimeve të nevojshme që rrisin sigurinë dhe gjurmimin e veprimeve.

**2.1 Rekomandim:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e politikave të sigurisë së të dhënave që aksesojnë përdoruesit e jashtëm dhe të brendshëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit.

**2.2 Rekomandim:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa teknike për sistemimin e gjurmës elektronike të auditimit në sistemin informatik të faturim-arkëtimit, si e vetmja mënyrë që siguron gjurmueshmërinë e të dhënave elektronike në rast të kundra vajtjeve administrative dhe operacionale.

**3. Titulli i Gjetjes:** Përdoruesit aktivë në bazën e të dhënave.

**Situata:** Nga auditimi mbi përdoruesit në bazën e të dhënave u konstatua se për drejtorin e IT janë aktivë dy përdorues të krijuar në bazën e të dhënave, si dhe vazhdon të jenë aktivë përdoruesit e operatorit që ka ofruar shërbim të mirëmbajtjes së sistemit të faturim-arkëtimit, megjithëse kontrata për këtë shërbim ka përfunduar.

**Kriteri:** Standardet mbi sigurinë e të dhënave që aksesohen direkt nga baza e të dhënave.

**Ndikimi/Efekti:** Krijimi i më shumë se sa është e nevojshme të përdoruesve që aksesojnë të dhënat nga databaza, përbën risk për humbje apo tjetërsim të të dhënave.

**Shkaku:** Mungesa e njohurive mbi risqet ndaj të cilave ekspozohet shoqëria, në rastet kur përdoruesit e bazës së të dhënave nuk monitorohen.

**3.1 Rekomandim:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për dokumentimin e përdoruesve të krijuar në bazën e të dhënave si dhe mbylljen e atyre që nuk janë duke ushtruar detyra funksionale që lidhen me shërbimin e mirëmbajtjes së sistemeve që disponon institucioni.

**4. Titulli i Gjetjes:** Kontratat e Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A me palët e treta nuk përmbajnë të dhëna teknike mbi aksesimin e të dhënave në sistemin informatik.

**Situata:** Nga auditimi mbi dokumentimin e VPN-ve të konfiguruar, u konstatua se:

- Kontratat e Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A me palët e treta nuk përmbajnë detaje teknike mbi implementimin, zbatimin dhe ndjekjen e kontratës;
- Disa nga operatorët privatë që aksesojnë të dhënat e sistemit të Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, u konstatua se kanë më shumë se një llogari VPN aktive, ndërsa nuk ka gjurmë dokumentare nëse janë miratuar lidhjet e dyta si dhe arsyet që kanë lindur për këtë konfigurim.
- UKT nuk ka ushtruar kontrole periodike mbi VPN që janë vënë në dispozicion të palëve të treta me qëllim kontrollin në çdo përpjekje autentifikimi, të dështuar ose të suksesshme, kohën dhe datën e secilës lidhje dhe shkëputje si dhe jo pak e rëndësishme sasia e të dhënave të transmetuara në çdo sesion.
- VPN dhe përdorues databaze të operatorit që ka ofruar shërbim mirëmbajtje, u konstatua të jenë aktive në sistem, megjithëse kontrata për shërbimin e mirëmbajtjes ka përfunduar.

Në kontratat me palët e treta për lidhjet VPN, nuk përcaktohen kushtet teknike, mënyrat e raportimit, kontrollet periodike që do të ushtrohen, penalitete të mundshme, persona kontakti teknik të dy palëve, etj., me qëllim informimin dhe adresimin e problematikave nga aksesime jo të sigurta.

**Kriteri:** Praktikrat me të mira.

**Ndikimi/Efekti:** Aksesim në të dhëna më tepër se sa mund të lejohet, risk mbi sigurinë e të dhënave, krijim i kushteve për sulme të jashtme.

**Shkaku:** Mungesa e politikave të sigurisë si dhe akteve rregullues për palët e treta që disponojnë apo kërkojnë një aksesim të sistemit informatik të UKT.

**Rëndësia:** E Lartë

**4.1 Rekomandim:** Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për rinovimin e kontratave me palët e treta që ofrojnë shërbime faturim – arkëtimi për llogari të institucionit nëpërmjet lidhjeve me VPN, në të cilën të bëhen pjesë detaje teknike mbi implementimin, zbatimin dhe ndjekjen e tyre.

**4.2 Rekomandim:** Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për monitorimin, pezullimin apo mbylljen në rast se do të jetë e nevojshme të lidhjeve aktive të VPN me të cilët nuk disponojnë një kontratë bashkëpunimi apo shërbimi.

*Në lidhje me këtë pikë të trajtuar nga grupi i auditimit, subjekti nuk ka paraqitur asnjë observacion, për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit në lidhje me këtë pikë.*

### *Përdoruesit e sistemit informatik*

Sistemi Billing ka 327 përdorues me statusin Aktiv dhe 364 përdorues me statusin In-aktiv Secili përdorues është i kategorizuar sipas rolit të tij.

*Tabela 13: Përdoruesit e sistemit Billing sipas roleve*

<b>Përdoruesit e Sistemit të Billing</b>	<b>Nr. Përdoruesish</b>
Administrator	10
Drejtor	10
Zv/drejtor	1
Specialist	231
Përgjegjës	44
Zyrë ankesash	6

*Burimi i të dhënave: Sistemi informatik i UKT*

Krijimi, administrimi i përdoruesve të sistemit *Billing*, realizohet nga drejtori dhe specialistët e menaxhimit të aplikacioneve të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit. Përzgjedhja e funksionaliteteve të çdo roli për punonjësin zgjidhet nga ndërfaqja e sistemit, fig.3.

*Fig. 3: Ndërfaqja e Sistemit Billing për krijimin e një përdoruesi të ri*

<b>Informacioni i Përdoruesit</b>			
<b>Përdoruesi:</b>	<input type="text"/>	<b>Fjalëkalimi:</b>	<input type="text"/>
<b>Emri:</b>	<input type="text"/>	<b>Mbiemri:</b>	<input type="text"/>
<b>Emri i plotë:</b>	<input type="text"/>	<b>Njësia:</b>	Të gjitha ▼
<b>Datëlindja:</b>	<input type="text"/>	<b>Mesazhi:</b>	<input type="text"/>
<b>Pozicion përdoruesi:</b>	Administrator ▼	<b>Statusi:</b>	Aktiv ▼
<b>ID ARKA / BANKA:</b>	Pa specifikuar ▼	<b>ID Departamenti:</b>	Pa specifikuar ▼
<b>Të drejtat:</b>			
<b>Admin. Përdoruesish:</b>	<input type="checkbox"/>	<b>Auditim SW:</b>	<input type="checkbox"/>
<b>Abonenti:</b>	<input type="checkbox"/>	<b>Faturim:</b>	<input type="checkbox"/>
<b>Arketim:</b>	<input type="checkbox"/>	<b>Arketim Online:</b>	<input type="checkbox"/>
<b>Konsultim:</b>	<input type="checkbox"/>	<b>Njesi:</b>	<input type="checkbox"/>
<b>Front office:</b>	<input type="checkbox"/>	<b>Raporte 1:</b>	<input type="checkbox"/>
<b>Raporte 2:</b>	<input type="checkbox"/>	<b>Ankesat:</b>	<input type="checkbox"/>
<b>Import / Export:</b>	<input type="checkbox"/>	<b>Printim Fature:</b>	<input type="checkbox"/>

Nga auditimi u konstatua se UKT Sh.A nuk disponon një rregullore të miratuar për procesin e menaxhimit të përdoruesve në sistemet që disponon me qëllim përcaktimin e attributeve si




krijimi, fshirja, ndryshimi i roleve, të drejtave, ndryshimi i fjalëkalimeve. Nga informacioni i marrë prej pyetësorëve dhe intervistimit të stafit IT procedura për krijimin e përdoruesit dhe përcaktimin e funksionaliteve është e thjeshtë dhe ndiet sipas hapave të mëposhtëm:

1. Drejtoria përkatëse të cilës i përket punonjësi i ri, plotëson një formular tip në të cilin vendosen të dhënat e punonjësit si dhe funksionet në të cilat nevojitet t'i jepet akses.
2. Ky formular i printuar në letër, me nënshkrimin e Drejtorit të Drejtorisë i përcillet Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit e cila e zbaton duke krijuar përdoruesin dhe funksionalitet mbi të cilat ka akses ky përdorues.
3. Përdoruesit me telefon apo e-mail i komunikohen kredencialet që i nevojiten për të hyrë në sistem që janë: emri i përdoruesit si dhe fjalëkalimi fillestar.

Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes Web u konstatua se portali nuk përdor një lidhje të sigurtë HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure), pra komunikimi ndërmjet web browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues.

Fig. 4: Aksesimi i sistemit



Në mungesë të kësaj certifikate mund të ndodhë humbja e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të këtij portali. Gjithashtu një sulmues i jashtëm, i cili arrin të hyj në rrjet, ka mundësi të lexojë dhe ndryshojë informacionin i cili aksesohet nga rrjeti, duke përfshirë jo vetëm fjalëkalimet-et por dhe të dhënat financiare të faturimit.

**5. Titulli i Gjetjes:** Mangësi teknike dhe rregullativë në përdoruesit e brendshëm.

**Situata:** Nga auditimi mbi të dhënat e përdoruesve të sistemit “Billing” u konstatua se:

- Për përdoruesin me të drejta të plota, në rolin e administratorit, nuk ka të dhëna të punonjësit që posedon këtë llogari;
- Janë aktiv katër përdorues me kredenciale të pa identifikuar që janë: njësia nr.1, njësia nr.2, njësia nr.3, njësia nr.4;
- Në shumë raste të krijimit të përdoruesve, nuk janë ruajtur të plota gjurmët se kush nga përdoruesit ka kryer veprimin;
- Në disa raste një punonjës ka më shumë se një llogari aktive në sistem;
- Fjalëkalimi i secilit përdorues në sistemin Billing në momentin e krijimit është standard, kur përdoruesi logohet për herë të parë (first log-in) ndryshimi i fjalëkalimit fillestar nuk kërkohet në mënyrë të detyrueshme të ndryshohet. Ky ndryshim mbetet në dëshirën apo njohuritë e punonjësit;
- Funksionalitetet e përdoruesve në sistem nuk janë të paracaktuara me rolin që i caktohet, ato përzgjidhen manualisht nga punonjësi që zbaton kërkesën për krijimin e llogarisë së re;

- Fjalëkalimi në sistemin Billing nuk është i parametrizuar për nga kompleksiteti dhe gjatësia e tij. Për kriteret e fjalëkalimit të përdoruesve fundor nuk janë hartuar apo implementuar standarde me qëllim forcimin e tij.

- Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes Web u konstatua se portali nuk përdor një lidhje të sigurtë HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure), pra komunikimi ndërmjet web browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues.

**Kriteri:** Ligji 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, Standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikatat më të mira.

**Ndikimi/Efekti:** Cenim i sigurisë mbi të dhënat / hyrje e paautorizuar në sistem.

**Shkaku:** Mungesa e akteve rregullativë dhe politikave mbi fjalëkalimin e përdoruesve.

**Rëndësia:** E lartë

**5.1 Rekomandim:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e politikave mbi fjalëkalimin e përdoruesve në sistemin “Billing” ku të përcaktohet kompleksiteti minimal në gjatësi, karaktere speciale apo numra si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij. Gjithashtu, të merren masa për hartimin dhe miratimin e rregullores për krijimin dhe administrimin e përdoruesve të brendshëm, ku të jenë pasqyruar saktë të drejtat dhe detyrimet që kanë përdoruesit mbi funksionalitetet e sistemit informatik “Billing”.

**5.2 Rekomandim:** Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit të konsiderojë, ndryshimin e fjalëkalimit me forcë nëpërmjet opsionit “Ndrysho fjalëkalimin në log-imin e radhës”, me qëllim rritjen e sigurisë në përdoruesit e brendshëm.

**5.3 Rekomandim:** Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, të marrë masa për vendosjen e certifikatës së sigurisë HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure) në mënyrë që të krijohet një kanal i sigurt për aksesimin e sistemit të faturim-arkëtimit “Billing”.

*Në lidhje me këtë pikë të trajtuar nga grupi i auditimit, subjekti nuk ka paraqitur asnjë observacion, për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit në lidhje me këtë pikë.*

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi aktet e brendshëm rregullativë, u konstatua se shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A nuk disponon një strategji institucionale si dhe një strategji mbi teknologjinë e informacionit, mungesa e të cilave sjell mangësi në vendosjen e prioritetëve të institucionit, politikave të sigurisë si dhe përmirësimin e infrastrukturës të TI të cilat do duhet të jenë në mbështetje të objektivave institucionale.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimeve që ofron, duhet të marrë masa për identifikimin, hartimin dhe zhvillimin e elementëve strategjikë në Teknologjinë e Informacionit që mbështesin strategjinë institucionale, ku nevojiten të merren në konsideratë të gjitha proceset për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se institucioni nuk ka një plan mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin në rritjen profesionale dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre me qëllim përmbushjen e detyrave në nivel të lartë profesional. Po ashtu, është konstatuar se specialistët e TI nuk kanë zhvilluar trajnime, kualifikime profesionale brenda apo jashtë vendit, gjatë periudhës objekt auditimi.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnime profesionale teknike të punonjësve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, si një mënyrë që nxit dhe përmirëson kryerjen e detyrave me nivel të lartë profesional. Trajnimet mbi teknologjinë e informacionit nevojitet të kryhen dhe tek punonjësit e tjerë, duke pasur parasysh elementët më të rëndësishëm si ruajtja e të dhënave, të drejtat dhe detyrimet mbi mjetet teknologjike që disponon institucioni dhe ka vënë në përdorim të punonjësve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A nuk disponon regjistër risku për periudhën objekt auditimi lidhur me teknologjinë e informacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për identifikimin dhe hartimin e regjistrit të riskut lidhur me teknologjinë e informacionit me qëllim identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e tyre, si një mënyrë për të minimizuar problematika të mundshme që lidhen me teknologjinë dhe përdorimin e saj.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit zhvilluar në drejtim të teknologjisë së informacionit për pajisje kompjuterike, licenca dhe mirëmbajtje, u konstatua se:

- Specifikimet teknike që janë bërë pjesë e dokumenteve të tenderit, nuk janë hartuar nga grupet e ngritura për këtë qëllim dhe në përputhje me dispozitat ligjore si dhe urdhrat e brendshëm.
- Metoda e përdorur për përlllogaritjen e fondit limit, bazuar në çmimet e tregut nuk është dokumentuar dhe argumentuar plotësisht në përputhje në përcaktimet e dispozitave ligjore.
- Kërkesat e vendosura mbi kapacitetin teknik nuk janë argumentuar nga ana teknike, por vetëm nga ana ligjore, çfarë është në kundërshtim me nenin 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikuar në nenin 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
- Raportet periodike të mirëmbajtjes nuk janë dokumentuar në përputhje me specifikimet teknike që janë pjesë integrale e tyre.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 14-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1 Rekomandimi:** Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për:

- Hartimin e specifikimeve teknike në prokurime të teknologjisë së informacionit, të cilat duhet të dokumentohen dhe argumentohen për çdo procedurë, përpara përlllogaritjes së fondit limit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ky dokument të nevojitet të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.
- Njësia përgjegjëse për prokurimet në teknologjinë e informacionit, në përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, të marrë në konsideratë specifikime teknike të hartuara nga strukturat e ngritura për këtë qëllim. Në rastet e mungesës së kësaj strukture, specifikimet teknike përlllogaritja e fondit limit, kapaciteti teknik, grafiku i lëvrimit apo hartimi i kritereve, nevojiten të hartohen nga vetë njësia.
- Dokumentimin dhe argumentimin e mënyrës së zgjedhur në llogaritjen e fondit limit, për procedura të zhvilluara për teknologjinë e informacionit. Ky dokument të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.
- Argumentimin teknik dhe ligjor të çdo kërkesë të vendosur në kapacitetin teknik, për procedurat e prokurimit që lidhen me teknologjinë e informacionit. Ky dokument të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.

- Ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të shërbimeve të mirëmbajtjes në teknologjinë e informacionit, në përputhje me kërkesat e parashikuara në specifikimet teknike, duke dokumentuar në këtë mënyrë të plotë gjurmën e shërbimit të realizuar nga ofruesi.

*Në vijimësi*

**4.2 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për përzgjedhjen dhe zhvillimin e trajnimeve specifike të zyrtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit si dhe për raste të veçanta të kërkojë nga APP mendime paraprake për trajnimin e tyre me qëllim realizimin e procedurave në vijimësi në përputhje me dispozitat ligjore.

*Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi sistemet informatike që disponon Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, u konstatua se të dhënat e abonentëve, matësve si dhe faturim-arkëtimin e administron me sistemin informatik “Billing”, por nuk disponon asnjë nga dokumentacionet e mëposhtme:

- Rregullore mbi përdorimin e sistemit;
- Rregullore operacionale mbi veprimet sistemuese që kryhen në sistem dhe bazën e të dhënave;
- Manual përdorimi;
- Diagramet e qarkullimit të informacionit;
- Kodin në burim;
- Dokumentacion udhëzues i ndërtimit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 43-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1 Rekomandimi:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e rregullores dhe manualit të përdorimit për sistemin informatik të faturim-arkëtimin në të cilat të përcaktohen detyrimet dhe rëndësia e veprimeve në këtë sistem, për çdo përdorues punonjës të institucionit që e akseson atë. Gjithashtu, të dokumentohen diagramet e qarkullimit të informacionit për secilin nga proceset që nis dhe përfundon nëpërmjet sistemit informatik të faturim - arkëtimin, duke siguruar në këtë mënyrë gjurmën e proceseve që kryhen nëpërmjet sistemit.

*Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2023*

**5.2 Rekomandimi:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e rregullores për veprimet operacionale, që nevojitet të kryhen në sistemin informatik për efekte sistemuese të shkaktuara nga gabimet njerëzore apo pamundësitë e njohura të sistemit nëpërmjet ndërfaqeve të sistemit. Për secilin prej ndryshimeve të parashikuara në rregullore të hartohen dhe miratohen formatet që sigurojnë gjurmën e veprimeve të kryera dhe të autorizuara sipas nevojës. Në këtë rregullore mund të përfshihen gjithashtu veprimet operacionale për pezullim të përkohshëm apo të përhershëm të aksesit të përdoruesve të jashtëm, dokumentimi i lidhjeve të reja, monitorimin periodik, që tregojnë për nivelin e aksesimit në sistemin informatik nga palët e treta që ofrojnë shërbime faturim – arkëtimin, për llogari të institucionit.

*Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2023*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi gjurmën elektronike të auditimit u konstatua se nuk gjenerohet gjurmë mbi veprimet që kryejnë përdoruesit e bazës së të dhënave.

Për përdoruesit e sistemit nga ndërfaqja, ruhen të dhëna të pakta që janë: hyrja, dalja, IP e përdoruesit si dhe mënyra e daljes nga sistemi. Kjo gjurmë elektronike është e pamjaftueshme, për të siguruar të dhëna mbi aktivitetin e tyre. Në të dhënat e faturimit për periudhën objekt auditimi u konstatua vetëm në një rast për një kontratë të caktuar, mungojnë rekordet e faturimit, çfarë tregon mundësinë për ndërhyrje në bazën e të dhënave.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 43-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1 Rekomandimi:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e politikave të sigurisë së të dhënave që aksesojnë përdoruesit e jashtëm dhe të brendshëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023*

**6.2 Rekomandimi:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa teknike për sistemimin e gjurmës elektronike të auditimit në sistemin informatik të faturim-arkëtimit, si e vetmja mënyrë që siguron gjurmueshmërinë e të dhënave elektronike në rast të kundra vajtjeve administrative dhe operacionale.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përdoruesit në bazën e të dhënave u konstatua se për drejtorin e IT-s janë aktivë dy përdorues të krijuar në bazën e të dhënave, si dhe vazhdon të jenë aktive përdoruesit e operatorit që ka ofruar shërbim të mirëmbajtjes së sistemit të faturim-arkëtimit, megjithëse kontrata për këtë shërbim ka përfunduar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 43-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1 Rekomandimi:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për dokumentimin e përdoruesve të krijuar në bazën e të dhënave si dhe mbylljen e atyre që nuk janë duke ushtruar detyra funksionale që lidhen me shërbimin e mirëmbajtjes së sistemeve që disponon institucioni.

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi dokumentimin e VPN-ve të konfiguruar, u konstatua se:

- Kontratat e Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A me palët e treta nuk përmbajnë detaje teknike mbi implementimin, zbatimin dhe ndjekjen e kontratës;
- Disa nga operatorët privatë që aksesojnë të dhënat e sistemit të Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, u konstatua se kanë më shumë se një llogari VPN aktive, ndërsa nuk ka gjurmë dokumentare nëse janë miratuar lidhjet e dyta si dhe arsytet që kanë lindur për këtë konfigurim.
- UKT nuk ka ushtruar kontrole periodike mbi VPN që janë vënë në dispozicion të palëve të treta me qëllim kontrollin në çdo përpjekje autentifikimi, të dështuar ose të suksesshme, kohën dhe datën e secilës lidhje dhe shkëputje si dhe jo pak e rëndësishme sasia e të dhënave të transmetuara në çdo sesion.
- VPN dhe përdorues databaze të operatorit që ka ofruar shërbim mirëmbajtje, u konstatua të jenë aktive në sistem, megjithëse kontrata për shërbimin e mirëmbajtjes ka përfunduar. Në kontratat me palët e treta për lidhjet VPN, nuk përcaktohen kushtet teknike, mënyrat e raportimit, kontrollet periodike që do të ushtrohen, penalitete të mundshme, persona kontakti teknik të dy palëve, etj., me qëllim informimin dhe adresimin e problematikave nga aksesime jo të sigurta.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 43-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1 Rekomandim:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për rinovimin e kontratave me palët e treta që ofrojnë shërbime faturim – arkëtimi për llogari të institucionit nëpërmjet lidhjeve me VPN, në të cilën të bëhen pjesë detaje teknike mbi implementimin, zbatimin dhe ndjekjen e tyre.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023*

**8.2 Rekomandim:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për monitorimin, pezullimin apo mbylljen në rast se do të jetë e nevojshme të lidhjeve aktive të VPN me të cilët nuk disponojnë një kontratë bashkëpunimi apo shërbimi.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e përdoruesve të sistemit “Billing” u konstatua se:

- Për përdoruesin me të drejta të plota, në rolin e administratorit, nuk ka të dhëna të punonjësit që posedon këtë llogari;



- Janë aktiv katër përdorues me kredenciale të pa identifikuar që janë: njësia nr.1, njësia nr.2, njësia nr.3, njësia nr.4;
  - Në shumë raste të krijimit të përdoruesve, nuk janë ruajtur të plota gjurmët se kush nga përdoruesit ka kryer veprimin;
  - Në disa raste një punonjës ka më shumë se një llogari aktive në sistem;
  - Fjalëkalimi i secilit përdorues në sistemin Billing në momentin e krijimit është standard, kur përdoruesi logohet për herë të parë (first log-in) ndryshimi i fjalëkalimit fillestar nuk kërkohet në mënyrë të detyrueshme të ndryshohet. Ky ndryshim mbetet në dëshirën apo njohuritë e punonjësit;
  - Funkcionalitetet e përdoruesve në sistem nuk janë të paracaktuara me rolin që i caktohet, ato përzgjidhen manualisht nga punonjësi që zbaton kërkesën për krijimin e llogarisë së re;
  - Fjalëkalimi në sistemin Billing nuk është i parametrizuar për nga kompleksiteti dhe gjatësia e tij. Për kriteret e fjalëkalimit të përdoruesve fundor nuk janë hartuar apo implementuar standarde me qëllim forcimin e tij.
  - Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes Web u konstatua se portali nuk përdor një lidhje të sigurtë HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure), pra komunikimi ndërmjet web browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 43-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
- 9.1 Rekomandimi:** Ujësja e Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e politikave mbi fjalëkalimin e përdoruesve në sistemin “Billing” ku të përcaktohet kompleksiteti minimal në gjatësi, karaktere speciale apo numra si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij. Gjithashtu, të merren masa për hartimin dhe miratimin e rregullores për krijimin dhe administrimin e përdoruesve të brendshëm, ku të jenë pasqyruar saktë të drejtat dhe detyrimet që kanë përdoruesit mbi funksionalitetet e sistemit informatik “Billing”.

***Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2023***

**9.2 Rekomandim:** Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit të konsiderojë, ndryshimin e fjalëkalimit me forcë nëpërmjet opsionit “Ndrysho fjalëkalimin në log-imin e radhës”, me qëllim rritjen e sigurisë në përdoruesit e brendshëm.

***Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2023***

**9.3 Rekomandim:** Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, të marrë masa për vendosjen e certifikatës së sigurisë HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure) në mënyrë që të krijohet një kanal i sigurt për aksesimin e sistemit të faturim-arkëtimit “Billing”.

***Menjëherë***

---

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi*

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**